



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 45

Tiranë – E mërkurë, 3 prill 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 15/2019 datë 13.3.2019	Për nxitjen e punësimit..... 3641
Ligj nr. 18/2019 datë 21.3.2019	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për Bashkëpunim Financiar 2016, për projektin “Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike P” 3649
Ligj nr. 19/2019 datë 21.3.2019	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për Bashkëpunimin Teknik 2017 Për projektin “Zhvillim i qëndrueshëm i zonave rurale” 3651
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 20.2.2019	Çështja Pulfer kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 31959/13</i>)..... 3653
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 41, datë 15.3.2019	Mbi rrëzimin e kërkesës së OST sh.a., mbi nevojën e ndërhyrjeve në rrjetin e transmetimit..... 3664
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 42, datë 15.3.2019	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shkurt 2019..... 3666
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 43, datë 15.3.2019	Mbi miratim e “Propozimit të të gjitha OST-ve për një metodologji të ofrimit të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës në përputhje me nenin 16, të rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222, të datës 24 korrik 2015, për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongestionëve”..... 3668
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 44, datë 15.3.2019	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike..... 3669
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 45, datë 15.3.2019	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike..... 3670

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 46, datë 19.3.2019	Mbi kërkesën e shoqërisë OSHEE sh.a., për shtyrjen për një periudhë tranzitore të afatit të pagesës së faturave për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar, nga ana e OSHEE sh.a. dhe çështje të tjera të rregullimit.....	3671
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 47, datë 19.3.2019	Mbi miratimin e kërkesës së OST sh.a. për një ndryshim në vendimin e ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017 mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të direktivës 72/2009 EC mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.....	3674
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 90, datë 27.3.2019	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Elbasan, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	3676
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 91, datë 27.3.2019	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Shkodër, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	3678
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 92, datë 27.3.2019	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Vlorë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	3680
Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 88, datë 15.3.2019	Autorizim i ndihmës shtetërore “Për fuqizimin e grave dhe nxitja e sipërmarrjes”.....	3682



LIGJ
Nr. 15/2019

PËR NXITJEN E PUNËSIMIT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj përcakton rregullat dhe mënyrën e funksionimit të sistemit publik të shërbimeve të punësimit, të programeve aktive e pasive të tregut të punës, si dhe organet përgjegjëse për menaxhimin e tyre, me përjashtim të rasteve kur rregullohen nga legjislacioni i posaçëm.

Neni 2

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim rritjen e punësueshmërisë së forcave të punës, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve dhe programeve publike të punësimit, të vetëpunësimit dhe të kualifikimit profesional.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Aftësim dhe rehabilitim për punë për personat me aftësi të kufizuara” janë shërbimet mbështetëse dhe asistencë për vlerësimin e aftësisë për punë të personit me aftësi të kufizuara, të cilat ofrohen nëpërmjet:

a) informimit, këshillimit profesional, vlerësimit të aftësive profesionale dhe gjetjes së punës;

b) vlerësimit të mundësisë për aftësim, dhe hartimit të programeve përkatëse;

c) aftësimit profesional, kualifikimit plotësues, rikualifikimit me programet e mbajtjes dhe përmirësimit të aftësive të punës deri në momentin e punësimit.

2. “Fondi” është Fondi Social i Punësimit, i krijuar sipas këtij ligji.

3. “Forca e punës” përfshin personat e punësuar dhe të papunët.

4. “Grupe të veçanta” janë punëkërkues të disavantazhuar në tregun e punës, si:

a) individët me statusin e jetimit që ndodhen në kushte të vështira ekonomike;

b) kryefamiljarë të vetëm, me fëmijë në ngarkim;

c) persona me aftësi të kufizuara, përfshirë personat që nuk dëgjojnë dhe invalidët e punës të vlerësuar pjesërisht të aftë për punë nga komisionet përkatëse;

ç) prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara;

d) persona me moshë mbi 55 vjeç;

dh) persona nga komuniteti rom dhe egjiptian;

e) persona që kanë vuajtur dënimin me burgim, apo ndaj të cilëve është vendosur pezullimi i vendimit me burgim dhe zëvendësimi i tij me një dënim alternativ;

ë) persona nga familje që përfitojnë nga programet e mbështetjes me të ardhura;

f) punëkërkues të papunë afatgjatë (të regjistruar si punëkërkues të papunë prej më shumë se një viti);

g) punëkërkues të papunë, të kthyer prej jo më shumë se dy vjetësh nga emigracioni;

gj) të mitur dhe të rinj në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur;

h) të rinjtë me moshë nën 29 vjeç;

i) viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit;

j) viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe viktimat e dhunës në familje;

k) nënat nën moshën 18 vjeç.

5. “Ministri” është ministri përgjegjës për çështjet e punësimit dhe zhvillimit të aftësive.

6. “Ministria” është ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe zhvillimit të aftësive.

7. “Person i vetëpunësuar” është personi që kryen një veprimtari të ligjshme, në përputhje me legjislacionin shqiptar, për llogari të tij, kundrejt një pagese ose forme tjetër fitimi.

8. “Përshtatje e arsyeshme” ka të njëjtin kuptim me atë që parashikohet në legjislacionin në fuqi për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.



9. “Politikat publike të punësimit” përfshijnë shërbimet e punësimit dhe programet aktive e pasive të tregut të punës, të cilat synojnë nxitjen e punësimit të punëkërkuesve të papunë, integrimin dhe përfshirjen sociale të grupeve të veçanta.

10. “Programe aktive të tregut të punës” janë programe që synojnë të mbajnë të punësuarit në tregun e punës, të mbështesin punëkërkuesit e papunë të hyjnë në tregun e punës, të rrisin produktivitetin dhe të ardhurat nga puna dhe të përmirësojnë funksionimin e tregut të punës.

11. “Programe pasive të tregut të punës” janë programet e të ardhurave nga papunësia, e cila jepet në zbatim të legjislacionit për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë.

12. “Punëdhënës” janë të gjithë personat, fizikë ose juridikë, që punësojnë punëkërkuesit dhe u paguajnë atyre shpërblimin për punën e kryer, sipas Kodit të Punës dhe legjislacionit në fuqi.

13. “Punëkërkues” është çdo person me vendbanim në Republikën e Shqipërisë, në moshë pune, që regjistrohet si kërkues pune në strukturën rajonale/vendore dhe është i gatshëm për punë.

14. “Punëkërkues i papunë, i regjistruar” është punëkërkuesi, i cili deklaron në strukturën përkatëse, që nuk është në marrëdhënie pune ose i vetëpunësuar dhe është i gatshëm menjëherë për punësim.

15. “Punëkërkues i punësuar, i regjistruar” është punëkërkuesi, i cili është i punësuar apo i vetëpunësuar, por që në momentin e regjistrimit deklaron në strukturën përkatëse se kërkon një punë të re.

16. “Punësueshmëri” është kombinimi i aftësive, i njohurive dhe i kompetencave që rritin mundësitë e personit për t’u punësuar, për të qëndruar i punësuar dhe për të përparuar në karrierë.

17. “Punësim i përshtatshëm” është punësimi i paguar i një personi, në përputhje me moshën, gjininë, kushtet shëndetësore, arsimimin, formimin profesional, vendbanimin, kohëzgjatjen e punësimit të mëparshëm, përvojën e fituar, ndikimin e punës në fjalë në gjendjen personale e familjare dhe në gjendjen e tregut të punës.

18. “Shërbime punësimi” janë shërbimet, të cilat synojnë të informojnë, të këshillojnë, të

orientojnë dhe të ndërmjetësojnë punësimin sa më të shpejtë të punëkërkuesve dhe punëkërkuesve të papunë të regjistruar, nëpërmjet ndihmës së shënjestruar dhe të zhvillojnë konkurrueshmërinë në tregun e punës.

19. “Struktura përkatëse rajonale/vendore e punësimit”, është struktura që ka kompetencën territoriale në zonën e vendbanimit të personit apo selisë/degës së punëdhënësit, i cili pretendon të përfitojë nga një ose disa shërbime apo programe të ofruara nga kjo strukturë.

20. “Struktura rajonale/vendore e punësimit” është struktura, pjesë e rrjetit të shërbimeve publike të punësimit, në varësi të institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë.

Neni 4

Përfituesit

1. Çdo punëkërkues dhe punëdhënës i regjistruar në strukturën rajonale/vendore përfiton nga shërbimet që ofrohen nga kjo strukturë.

2. Të drejtën e përfitimit të shërbimeve që ofrohen në strukturën rajonale/vendore e kanë të gjithë shtetasit e huaj dhe ata pa shtetësi, të cilët hyjnë e qëndrojnë në mënyrë të ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, për qëllime punësimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të huajt.

3. Të drejtën e përfitimit të këtyre shërbimeve e kanë edhe të huajt, të cilët kanë përfituar statusin e refugjatit, si dhe azilkërkuesit në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për azilin.

4. Shërbimet e punësimit i ofrojnë mundësinë të huajve të pajisen me leje pune, në zbatim të legjislacionit në fuqi për të huajt.

KREU II

POLITIKAT PUBLIKE TË PUNËSIMIT

Neni 5

Kompetencat e ministrisë në lidhje me politikat e punësimit

1. Ministria, në lidhje me politikat e punësimit, ushtron këto kompetenca:

a) analizon periodikisht tendencat e tregut të punës dhe parashikon zhvillimet e tij;

b) harton politika të reja për rritjen e punësimit dhe uljen e papunësisë;



c) harton programe dhe merr masa për nxitjen e punësimit e të vetëpunësimit;

ç) harton programe për mbështetjen e ofruesve të arsimit e të formimit profesional, duke përfshirë ofrimin e kualifikimit fillestar dhe të vazhduar;

d) rregullon dhe ndërhyt në punësimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi për të huajt dhe mbështet punësimin e shtetasve shqiptarë jashtë vendit;

dh) zbaton marrëveshjet ndërkombëtare për punësimin.

2. Zbatimi i politikave publike të punësimit kryhet nëpërmjet institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, që ngrihet sipas parashikimeve të këtij ligji, dhe strukturave rajonale/vendore në varësi të saj.

KREU III PROGRAMET AKTIVE TË TREGUT TË PUNËS

Neni 6

Programet aktive të tregut të punës

1. Programet aktive të tregut të punës përfshijnë mekanizma që synojnë të mbajnë të punësuarit në tregun e punës, të mbështesin punëkërkuesit e papunë të hyjnë në tregun e punës, të rrisin produktivitetin dhe të ardhurat nga puna dhe të përmirësojnë funksionimin e tregut të punës.

2. Programet aktive të tregut të punës përfshijnë:

- a) shërbimet e punësimit;
- b) programet e nxitjes së punësimit;
- c) programet e formimit profesional.

Neni 7

Shërbimet e punësimit

1. Shërbimet e punësimit, të ofruara nga struktura rajonale/vendore, përfshijnë modelin e shërbimeve në tri nivele:

- a) shërbimet e informimit për punëkërkuesit, punëdhënësit dhe për çdo person të interesuar;
- b) ndërmjetësimin për punësim;
- c) këshillimin dhe orientimin për karrierë, punësim e profesion.

2. Shërbimet e punësimit, sipas pikës 1 të këtij neni, ofrohen pa pagesë, si për punëkërkuesit, ashtu dhe për punëdhënësit.

3. Ministria merr të gjitha masat për të krijuar infrastrukturën e nevojshme, burimet njerëzore e materiale për të siguruar ofrimin, në strukturën rajonale/vendore, të shërbimeve të specializuara për grupet e veçanta, të cilat kërkojnë ndihmë për përfshirjen e tyre në tregun e punës.

4. Ministria, në bashkëpunim me aktorë të tjerë publikë, privatë, ose organizata të shoqërisë civile, mbështet pajisjen dhe përgatitjen e posaçme të stafit të strukturës rajonale/vendore për të ofruar nivele cilësore të ndërmjetësimit për punësim.

5. Procedurat, kriteret dhe rregullat për ofrimin e shërbimeve të punësimit, sipas pikës 1 të këtij neni, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Veprimtaritë e ndërmjetësimit për punësim dhe këshillim profesional nga subjektet private, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë X.2 të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet.

Neni 8

Informimi i punëkërkuesve dhe punëdhënësve

1. Struktura rajonale/vendore e punësimit siguron dhe ofron informacion për kërkesën e ofertën në tregun e punës, si për punëkërkuesit, ashtu dhe për punëdhënësit. Shërbimi përfshin informacion për:

- a) tregun kombëtar, lokal dhe rajonal të punës;
- b) shërbimet e punësimit dhe programet për punëdhënësit e punëkërkuesit;
- c) mundësitë e punësimit;
- ç) ofertat arsimore e kualifikuese të institucioneve të arsimit dhe formimit profesional;
- d) orientimin për profesion dhe karrierë;
- dh) të drejtën për të përfituar nga programet e mbështetjes, të ardhurat dhe procedurat e aplikimit;
- e) legjislacionin e punës.

2. Informacioni ofrohet në forma dhe formate që janë të arritshme e të kuptueshme për punëkërkuesit e parashikuar në nenin 3, pika 4, shkronja “c”, të këtij ligji.



Neni 9

Ndërmjetësimi për punësim dhe përputhja me vendin e punës

1. Ndërmjetësimi për punësim dhe përputhja me vendin e punës synon gjetjen e një vendi të përshtatshëm pune për punëkërkuuesin, formimi, aftësitë e cilësitë e të cilit përputhen me kërkesat e deklaruara nga punëdhënësi për këtë vend pune, si dhe ndërmjetësime për programet aktive të tregut të punës.

2. Ndërmjetësimi për punësim dhe përputhja me vendin e punës përfshin edhe shërbime këshilluese për punëdhënësit, me qëllim që të punësojnë kandidatët më të përshtatshëm, sipas kërkesave të tyre dhe në kohën e duhur, si dhe ndërmjetësime për programet aktive të tregut të punës. Në rastin e një punëkërkuesi, të parashikuar në nenin 3, pika 4, shkronja “c”, të këtij ligji, procesi i ndërmjetësimit shoqërohet me vlerësim të detajuar të punëkërkuetit, këshillim për punëdhënësit dhe të vendit e të proceseve të punës të vlefshme në tregun e hapur të punës.

3. Ndërmjetësim për punësim vlerësohet edhe rasti kur, në zbatim të marrëveshjeve ose lejeve të posaçme për punë, mundësohet punësimi i punëkërkuettesve shqiptarë jashtë vendit dhe i të huajve brenda vendit.

Neni 10

Këshillimi dhe orientimi për karrierë, punësim dhe profesion

1. Këshillimi dhe orientimi për karrierë, punësim e profesion ofrohet nga struktura rajonale/vendore e punësimit nëpërmjet shërbimeve këshilluese të posaçme për punëkërkuettesit, nxënësit dhe studentët, në lidhje me zgjedhjen dhe formimin e tyre në një profesion të përshtatshëm, me cilësitë individuale dhe orientimin në tregun e punës.

2. Këshillimi i specializuar ofron shërbime më të thelluara, të arritshme, të kuptueshme për grupet e veçanta, të cilat kanë pengesa për t'u përfshirë në punësim dhe profili i të cilave kërkon mbështetje intensive.

3. Këshillimi dhe orientimi për karrierë, punësim dhe profesion realizohet nëpërmjet këshillimit për:

a) karrierë, që ndihmon punëkërkuettesit dhe orienton nxënësit dhe studentët në zgjedhjen e

një profesioni të përshtatshëm me cilësitë individuale dhe për të kërkuar në tregun e punës;

b) profesion, që ndihmon punëkërkuettesit, nxënësit dhe studentët për identifikimin e aftësive të munguara dhe ofrimin e mjeteve të përshtatshme për plotësimin e tyre;

c) punësim, që ndihmon punëkërkuettesit, nxënësit dhe studentët për të identifikuar qëllimin e punësimit, qasjen në punësim dhe mundësitë e kualifikimeve, si dhe të kuptojnë aftësitë e nevojshme për të kërkuar e mbajtur një vend pune.

Neni 11

Programet e nxitjes së punësimit

1. Politikat publike të punësimit mbështesin punëkërkuettesit, si dhe punëdhënësit, për të krijuar vende të reja pune të qëndrueshme, nëpërmjet programeve të posaçme të nxitjes së punësimit.

2. Programet e nxitjes së punësimit përfshijnë angazhimin e punëkërkuettesve të papunë në programe të ndryshme punësimi, punësh publike, vetëpunësimi, praktikash profesionale apo trajnimi, për të cilat parashikohet subvencionim, në përqindje të caktuar, i kostove për:

a) sigurimet e detyrueshme shëndetësore dhe shoqërore;

b) pagat;

c) formimin profesional;

ç) formimin nëpërmjet punës;

d) vetëpunësimin;

dh) mbështetjen për bizneset e reja dhe inkubatorët e biznesit;

e) pajisjen e vendit të punës dhe përshtatjen e arsyeshme;

ë) zbatimin e programeve për mbështetjen e kualifikimit profesional në formën e dyfishtë të arsimit dhe formimit profesional;

f) punësimin e të diplomuarve/certifikuarve në arsimin e formimin profesional;

g) praktikat profesionale;

gj) programin e garancisë rinore;

h) programet e riintegrit social;

i) transport për në vendin e punës;

j) ndjekjen e kopshteve dhe çerdheve për fëmijët në ngarkim;

k) të tjera.

3. Programet e nxitjes së punësimit zbatohen dhe administrohen nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, në bashkëpunim me



institucione të tjera publike, përgjegjëse për zhvillimin ekonomik e kualifikimin, si dhe në bashkëpunim me sektorin privat dhe organizata të shoqërisë civile.

Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë mund të kontraktojë subjekte të tjera publike, private apo organizata të shoqërisë civile, veprimtaria e të cilëve është e lidhur me fushën e punësimit, për të bërë të mundur zbatimin me cilësi dhe në kohë të programeve të nxitjes së punësimit.

4. Procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit, sipas pikave 2 dhe 3, të këtij neni, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Programet e formimit profesional

1. Formimi profesional u shërben si punëkërkuessve, ashtu dhe punëdhënësve dhe realizohet nëpërmjet kurseve të unifikuara të formimit profesional publik.

2. Strukturat rajonale/vendore të punësimit mbështesin financiarisht, në bazë procedurash konkurrimi, kurse të formimit profesional, të organizuara nga institucionet e formimit profesional, publike apo private.

3. Punëkërkuessit e papunë përfitojnë kurse pa pagesë të formimit profesional, të ofruara nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë. Punëkërkuessit e papunë, në raste të veçanta, mund të përfitojnë një pagesë për pjesëmarrje në kurs, si dhe subvencionimin e shpenzimeve të udhëtimit, sipas tarifave në fuqi. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim rregullat e subvencionimit të shpenzimeve të udhëtimit, rastet e përfitimit dhe masën e pagesës për pjesëmarrje në kurs.

4. Parimet, mënyrat e veprimit dhe metodat e përgatitjes profesionale, të zbatuara, përgjithësisht, në programet e formimit profesional të personave jo me aftësi të kufizuara, zbatohen në rastin e personave të parashikuar në nenin 3, pika 4, shkronja “c”, të këtij ligji. Për këtë grup zbatohen elementet e përshtatjes së arsyeshme, për sa u përket programeve të veçanta të trajnimit, kurrikulës së përshtatur në përputhje me shkallën dhe llojin e aftësisë së kufizuar, trajnerëve/mësuesve të përgatitur për të ofruar trajnim të posaçëm për këtë kategori.

5. Procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të formimit profesional, sipas pikave 2 dhe 4, të këtij neni, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU IV

PROGRAMET PASIVE TË TREGUT TË PUNËS

Neni 13

Pagesa e të ardhurave nga papunësia

Punëkërkuessit e papunë, të cilët plotësojnë kushtet për përfitimin e të ardhurave nga papunësia dhe regjistrohen në strukturën rajonale/vendore si punëkërkuess të papunë në zbatim të legjislacionit për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, përfitojnë nga pagesa e të ardhurave nga papunësia.

KREU V

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS PËR PUNËSIMIN DHE AFTËSITË

Neni 14

Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë

1. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë është person juridik publik në varësi të ministrisë përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe zhvillimit të aftësive, i organizuar në nivel qendror dhe rajonal/vendor.

2. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë ushtron kompetencat e mëposhtme:

a) administron strukturat rajonale/vendore të punësimit dhe garanton nivelin e cilësisë së shërbimeve të ofruara;

b) në bashkëpunim me punëdhënësit, administron dhe zbaton programet e nxitjes së punësimit;

c) administron ofruesit publikë të arsimit dhe formimit profesional (AFP), sipas legjislacionit në fuqi për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë;

ç) zbaton programet e formimit profesional;

d) i propozon ministrisë përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe zhvillimit të aftësive aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e nxitjes së punësimit;

dh) ushtron kompetenca të parashikuara nga ky ligj dhe nga ligje të tjera.



3. Rregullat e organizimit dhe funksionimit të institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 15

Këshilli Konsultativ për Punësimin

1. Këshilli Konsultativ për Punësimin është organ këshillimor që ngrihet pranë institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, me përfaqësimin e organizatave të punëdhënësve, organizatave sindikale, si dhe institucioneve shtetërore.

2. Këshilli kryesohet nga ministri dhe përbëhet nga 11 anëtarë, si më poshtë:

a) 1 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat;

b) 1 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale;

c) 1 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin;

ç) 1 përfaqësues nga inspektorati shtetëror që mbulon fushën e punës;

d) 1 përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

dh) 1 përfaqësues nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;

e) 2 përfaqësues nga organizatat më të përfaqësuara sindikale;

ë) 2 përfaqësues nga organizatat më të përfaqësuara të punëdhënësve.

3. Anëtarët e Këshillit emërohen me urdhër të ministrit, pas propozimit nga institucionet/organizatat e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, për një mandat 3-vjeçar.

4. Përzgjedhja e organizatave më të përfaqësuara sindikale dhe të punëdhënësve bëhet nga ministri, sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për caktimin e organizatave më të përfaqësuara sindikale dhe të punëdhënësve.

5. Këshilli Konsultativ për Punësimin ushtron kompetencat e mëposhtme:

a) diskuton çështjet që lidhen me shërbimet e punësimit dhe programet e nxitjes së punësimit;

b) nxit bashkëpunimin efektiv ndërmjet organizatave të punëdhënësve dhe organizatave sindikale për çështjet e nxitjes së punësimit;

c) këshillon lidhur me mënyrën e përdorimit të Fondit Social të Punësimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.

6. Rregulla më të detajuara për organizimin, funksionimin dhe kompetencat e Këshillit Konsultativ për Punësimin përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VI

SISTEMI I INFORMACIONIT PËR TREGUN E PUNËS

Neni 16

Të drejtat dhe detyrimet e institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë për informacionin e tregut të punës

1. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë mbledh, përpunon dhe analizon informacion nëpërmjet sistemit të informacionit të institucioneve të varësisë ose nëpërmjet studimeve specifike apo anketimeve, që kanë të bëjnë me dinamikën dhe tendencat e tregut të punës apo të segmenteve të tij. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë raporton në ministri dhe në institucione të tjera publike e private, që e kërkojnë një informacion të tillë.

2. Për sigurimin e këtij informacioni, institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë ka si detyrim:

a) mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e informacionit për punëkërkuesit e papunë, si dhe për vendet e lira të punës të shpallura në strukturën rajonale/vendore;

b) kryerjen e studimeve periodike mbi tregun e punës apo të një pjese të tij, në nivel rajonal dhe kombëtar;

c) kryerjen e monitorimit dhe vlerësimit të efikasitetit të programeve aktive të tregut të punës, si dhe ndjekjen në vazhdimësi të tyre.

3. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë kryen hulumtime periodike në tregun e punës për mbledhjen e të dhënave për numrin e të punësuarve, për kushtet e punës, procesin e rekrutimit, mungesën e aftësive apo të nevojave për trajnim, sipas metodologjive kombëtare dhe ndërkombëtare, të testuara e të miratuara.

Neni 17

Mbledhja, shpërndarja e të dhënave dhe bashkëpunimi me institucione të tjera

1. Ministria i siguron institucionit përgjegjës për statistikat zyrtare, statistikat e papunësisë së regjistruar, përveç atyre që rrjedhin nga



regjistrimi i popullsisë dhe vëzhgimet statistikore të autorizuar nga institucioni përgjegjës për statistikat zyrtare, si anketa e forcave të punës.

2. Ministria administron informacionin e mbledhur, në koordinim me institucionin përgjegjës për statistikat zyrtare, në mënyrë që të ketë një sistem të harmonizuar të mbledhjes së të dhënave dhe analizave.

3. Çdo institucion i administratës publike ka detyrimin e dhënies së informacionit, të kërkuar nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, për qëllimet e zbatimit të këtij ligji, në përputhje me rregullat dhe afatet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, si dhe ka të drejtën që të kërkojë e të marrë informacion prej saj.

4. Ruajtja dhe përpunimi i informacionit, që shkëmbehet sipas parashikimeve të pikës 3 të këtij neni, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU VII

BASHKËPUNIMI ME PUNËDHËNËSIT

Neni 18

Të drejtat e punëdhënësve

1. Çdo punëdhënës ka të drejtë të informohet për politikën e tregut të punës, legjislacionin e punës, programet e nxitjes së punësimit dhe programet e arsimit dhe formimit profesional, nëpërmjet strukturave rajonale/vendore të institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë.

2. Punëdhënësi ka të drejtë të publikojë në këtë strukturë vendet e lira të punës, nëpërmjet sistemit të informacionit të strukturave rajonale/vendore, për të përfituar nga shërbimet e ndërmjetësimit dhe të përputhjes me vendin e punës që ato ofrojnë.

3. Punëdhënësi ka të drejtë të aplikojë në strukturën përkatëse rajonale/vendore për të përfituar nga programet e nxitjes së punësimit dhe të kualifikimeve që zbaton institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë.

Neni 19

Detyrimet e punëdhënësve

1. Në rastet e fillimit të procedurave të falimentit me kërkesë të punëdhënësit, sipas legjislacionit në fuqi për falimentin, ky i fundit njofton strukturën përkatëse rajonale/vendore,

jo më vonë se 20 ditë kalendarike, për vendimin e gjykatës për fillimin e procedurave të falimentit.

2. Çdo punëdhënës, përfitues i fondeve publike, është i detyruar të punësojë një numër të caktuar punëkërkuesish të papunë, të regjistruar në strukturat rajonale/vendore, duke i dhënë përparësi punësimit të punëkërkuesve të papunë afatgjatë.

3. Rregullat dhe procedurat për zbatimin e pikës 2, të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 20

Punësimi i personave nga grupet e veçanta

1. Çdo punëdhënës duhet të punësojë:

a) një person që i përket grupeve të përcaktuara në nenin 3, pika 4, shkronja “c”, të këtij ligji, për 25 punonjësit e parë të ndërmarrjes; dhe

b) nga një person shtesë, sipas grupeve të përcaktuara në nenin 3, pika 4, shkronja “c”, të këtij ligji, për çdo 50 punonjës të tjerë të ndërmarrjes mbi parashikimet e bëra në shkronja “a” të kësaj pike.

2. Punëdhënësi, i cili nuk punëson numrin e përcaktuar të personave, sipas pikës 1, të këtij neni, derdh një kontribut për llogari të Fondit Social të Punësimit, në masën e 100 për qind të pagës minimale në shkallë vendi, për çdo muaj, për çdo person që i përket grupeve të përcaktuara në nenin 3, pika 4, shkronja “c”, të këtij ligji, që ai duhet të kishte punësuar, sipas këtij neni. Procedura dhe mënyra e derdhjes së kontributit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet e punësimit dhe zhvillimit të aftësive.

3. Punëdhënësit marrin masat e nevojshme për plotësimin e vendeve të lira të punës me personat që i përkasin grupeve të përcaktuara në nenin 3, pika 4, shkronja “c”, të këtij ligji. Në rastin kur punëdhënësi nuk mund të identifikojë kandidatët për punësim, për zbatimin e pikës 1, të këtij neni, paraqet kërkesë pranë strukturës përkatëse rajonale/vendore, e cila vë në dispozicion listën e punëkërkuesve të papunë të regjistruar për këtë kategori. Për qëllime të zbatimit të kësaj pike, struktura rajonale/vendore ndërmjetëson lidhur me përputhjen e vendit të punës me mundësitë e këtyre personave.



4. Punëdhënësit, publikë dhe privatë, mund të punësojnë në një njësi prodhimi, një numër më të madh punonjësish, që përkasin grupeve të përcaktuara në nenin 3, pika 4, shkronja “c”, të këtij ligji, se ajo e parashikuar sipas pikës 1, të këtij neni. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësinë mund të lejojë kompensimin e tepërive të numrit më të vogël të punonjësve të punësuar në njësi tjetër të këtij subjekti, në të njëjtin rajon apo në rajone të tjera.

5. Punëdhënësit, publikë apo privatë, janë të detyruar të sigurojnë ruajtjen e vendit të punës për ata individë, të cilët, në kohën e punësimit nuk kanë qenë me aftësi të kufizuara, por e kanë fituar aftësinë e kufizuar nga aksidentet në punë ose nga sëmundjet profesionale.

Neni 21

Fondi Social i Punësimit

1. Për të siguruar nxitjen e punësimit, integrimin dhe përfshirjen sociale të personave të parashikuar në nenin 3, pika 4, shkronja “c”, të këtij ligji, krijohet Fondi i Social i Punësimit, në formën e një fondi financiar publik.

2. Fondi krijohet nga:

a) kontributet e derdhura në llogari të Fondit, sipas pikës 2, të nenit 20, të këtij ligji;

b) të ardhura të tjera të krijuara nga burime të tjera të ligjshme, përfshirë:

i. financime dhe grante;

ii. fondet e përfituara nga marrëveshjet ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave dhe donatorëve të ndryshëm;

c) buxheti i shtetit.

3. Të ardhurat dhe kontributet për llogari të Fondit derdhen tek institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë dhe janë zë më vete në buxhetin e saj. Fondi Social i Punësimit i papërdorur në vitin korrent mbartet në vitin buxhetor pasardhës.

4. Fondi Social i Punësimit përdoret për programe që synojnë punësimin, vetëpunësimin, rehabilitim për punë, aftësimin dhe riaftësimin profesional, orientimin dhe këshillimin për punësim, shërbime mbështetëse, rikonstruksion dhe përshtatje të vendit të punës të personave të parashikuar në nenin 3, pika 4, shkronja “c”, të këtij ligji, programe riintegrimi social, mbështetje për nxitjen e punësimit të familjarëve të personave me aftësi të kufizuara. Të ardhurat e

Fondit Social të Punësimit, sipas pikës 2, të këtij neni, nuk mund të përdoren për qëllime të tjera, përveç atyre të parashikuara në këtë pikë.

5. Punëdhënësit kanë të drejtë të kërkojnë subvencion nga struktura përkatëse rajonale/ vendore për rikonstruksion dhe përshtatjen e vendit të punës, për çdo person të punësuar, sipas parashikimeve të nenit 20 të këtij ligji.

6. Fondi Social i Punësimit administrohet nga Bordi i Administrimit të Fondit, sipas legjislacionit në fuqi. Përbërja, kriteret dhe detyrat e Bordit të Administrimit të Fondit, si dhe mënyra e përdorimit të Fondit, sipas pikave 4 dhe 5, të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VIII SANKSIONET

Neni 22 Sanksionet

1. Shkelja e parashikimeve të pikës 2, të nenit 20, të këtij ligji, konsiderohet kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga inspektoratit shtetëror që mbulon fushën e punës, sipas përcaktimeve të bëra nga legjislacioni në fuqi për inspektimin e punës.

2. Procedurat e shqyrtimit dhe ankimit të vendimeve për kundërvajtjet administrative bëhen në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për inspektimin e punës.

KREU IX DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 23 Dispozita kalimtare

1. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë ngrihet brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi të këtij ligji.

2. Deri në momentin e krijimit të institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, funksionet e saj kryen nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

3. Të gjitha të drejtat, detyrimet, buxheti, si dhe dokumentacioni administrativ dhe financiar i Shërbimit Kombëtar të Punësimit i transferohen institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, pas ngritjes së tij.

4. Aktet nënligjore, në zbatim të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit”,



të ndryshuar, mbeten në fuqi deri në miratimin e akteve të reja nënligjore, në zbatim të këtij ligji, për sa kohë nuk bien në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji.

Neni 24
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 14, pika 3, të këtij ligji.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 7, pika 5; nenit 11, pika 4; nenit 12, pikat 3 dhe 5; nenit 15, pika 6; nenit 19, pika 3; dhe nenit 21, pika 6, të këtij ligji.

3. Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet e punësimit dhe zhvillimit të aftësive që, brenda dymbëdhjetë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të pikës 2, të nenit 20, të këtij ligji.

Neni 25
Shfuqizime

Ligji nr. 7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 26
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar më 13.3.2019.

Shpallur me dekretin nr. 11152, datë 28.3.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

LIGJ
Nr. 18/2019

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM
FINANCIAR 2016, PËR PROJEKTIN
“PROGRAMI I INVESTIMEVE PËR
SHPËRNDARJEN E ENERGJISË
ELEKTRIKE I”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2016, për projektin “Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar më 21.3.2019.

Shpallur me dekretin nr. 11153, datë 28.3.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

**MARRËVESHJE****NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM
FINANCIAR 2016 PËR PROJEKTIN
“PROGRAMI I INVESTIMEVE PËR
SHPËRNDARJEN E ENERGJISË
ELEKTRIKE I”**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë,

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë,

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje, me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë,

duke iu referuar protokollit të bisedimeve ndërqeveritare të datës 12 korrik 2016 dhe premtimeve të Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë, datë 29 nëntor 2016 (nota verbale nr. 349/2016),

kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose marrësve të tjerë, të cilët do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) për projektin “Programi investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I” shumat e mëposhtme:

1) një kredi të butë të KfW-së, e cila jepet në kuadër të bashkëpunimit publik për zhvillim, në vlerë të përgjithshme deri në 30 000 000 euro (me fjalë: tridhjetë milionë euro), nëse nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur, dhe kur Republika e Shqipërisë vazhdon të jetë e besueshme lidhur me kreditë dhe kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë jep garanci shtetërore, në rast se ai vetë nuk është huamarrës. Ky projekt nuk mund të zëvendësohet nga projekte të tjera;

2) një shumë financimi prej gjithsej 2 000 000 euro (me fjalë: dy milionë euro) për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit.

2. Shuma e financimit e përmendur në paragrafin 1, shifra 2, mund të përdoret për projekte të tjera, nëse për këtë bien dakord Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau kredi ose suma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 apo për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, gjen zbatim kjo marrëveshje.

Neni 2

1. Përdorimi i shumave të përmendura në nenin 1, kushtet me të cilat vihen në dispozicion ato, si dhe procedura e dhënies së porositë përcaktohen në kontratat që do të lidhen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësve të huas dhe shumës së financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumave të përmendura në nenin 1 do të zhvlerësohet, në rast se kontratat përkatëse të huas dhe financimit nuk lidhen brenda një afati prej gjashtë vitesh pas vitit të premtimeve. Afati për shumat e përmendura mbaron më 31 dhjetor 2022.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrës i kredisë, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat me euro për shlyerjen e borxheve të marrësve të huas në bazë të kontratave, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrës i shumës së financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat për shlyerjen e detyrimeve që mund të lindin në bazë të kontratave të financimit, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton KfW-në nga të gjitha tatimet dhe taksat



direkte, që linden në Republikën e Shqipërisë në kontekstin e lidhjes dhe zbatimit të kontratave të përmendura në nenin 2 paragrafi 1. Tatimi mbi vlerën e shtuar, si dhe taksa e tatime të ngjashme indirekte që linden në këtë kontekst, mbarten nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë. Taksat e veçanta të konsumit, që linden në këtë kontekst, mbarten nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë. Krahas kësaj Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton KfW-në nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e lë në gjykimin e pasagjerëve dhe furnizuesve të zgjedhin lirisht mes ndërmarrjeve transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, transport ky që rezulton nga dhënia e shumave të financimit, si dhe nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me seli në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr sipas rastit lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

2. Mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen në dakordësi mes palëve kontraktuese përmes bisedave apo bisedimeve përkatëse.

3 Regjistrimi i kësaj marrëveshjeje pranë Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara sipas nenit 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara realizohet menjëherë pas hyrjes së saj në fuqi prej Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Pala tjetër kontraktuese njoftohet rreth regjistrimit të kryer përmes përcjelljes së numrit të regjistrimit të Kombeve të Bashkuara, sapo ky numër të jetë konfirmuar prej Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara.

Bërë në Tiranë, në _____, në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS
FEDERALE TË GJERMANISË

LIGJ
Nr. 19/2019

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN
TEKNIK 2017 PËR PROJEKTIN
“ZHVILLIM I QËNDRUESHËM I
ZONAVE RURALE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik 2017, për projektin “Zhvillim i qëndrueshëm i zonave rurale”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar më 21.3.2019.

**Shpallur me dekretin nr. 11154, datë 28.3.2019
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta**



MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM TEKNIK 2017 PËR PROJEKTIN “ZHVILLIM I QËNDRUESHËM I ZONAVE RURALE”

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës së Shqipërisë,

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet Bashkëpunimit Teknik si partnerë,

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje, me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë,

duke iu referuar premtimit financiar të Republikës Federale të Gjermanisë (nota verbale nr. 294/2017, datë 23 nëntor 2017),

kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

1. Në zbatim të Marrëveshjes gjermano-shqiptare, të datës 21 tetor 1988, mbi Bashkëpunimin Teknik do të mbështetet projekti i mëposhtëm:

“Zhvillim i qëndrueshëm i zonave rurale” [PN: 2017.2192.7],

nëse nga shqyrtimi përkatës rezulton, se ky projekt vlen për t'u mbështetur.

2. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë vë në dispozicion për projektin e përmendur në paragrafin 1 shërbime në personel dhe materiale, si dhe eventalisht kontribute financimi (grante) në një vlerë të përgjithshme prej gjithsej 2 000 000 eurosh (me fjalë: dy milionë euro). Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë ngarkon me zbatimin e projektit Shoqërinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit - GIZ GmbH).

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë garanton një planifikim të vetin buxhetor, ku shpenzimet e ndryshme klasifikohen

në zëra më vete, që të sigurojë kështu zbatimin e vazhdueshëm të projektit të përmendur në paragrafin 1 dhe kujdeset që institucionet e ngarkuara prej tij me zbatimin e projektit të kryejnë shërbimet e nevojshme për projektin e përmendur në paragrafin 1.

4. Premtimi financiar për projektin e Bashkëpunimit Teknik, të përmendur në paragrafin 1 dhe shumën e përmendur në paragrafin 2 do të zhvlerësohet pa kompensim, në rast se brenda katër viteve pas vitit të premtimit financiar nuk janë lidhur ende kontrata përkatëse e zbatimit të përmendur në paragrafin 2 dhe eventalisht kontrata e financimit. Për këtë shumë, afati përfundon me mbarimin e datës 31 dhjetor 2021. Nëse kontratat e zbatimit dhe, eventalisht të financimit, lidhen brenda afateve të parashikuara vetëm për një pjesë të premtimit financiar, atëherë kjo klauzolë zhvlerësimi vlen vetëm për atë pjesë të fondeve që nuk është ende objekt i këtyre kontratave.

Neni 2

Hollësitat e projektit të përmendur në nenin 1, paragrafi 1, si dhe ato mbi detyrimet dhe shërbimet që duhet të kryhen, do të përcaktohen në kontrata të veçanta zbatimi dhe eventalisht financimi, që do të lidhen ndërmjet institucioneve që janë ngarkuar apo do të ngarkohen me zbatimin e projektit në kuptimin e nenit 1, paragrafët 2 dhe 3. Kontratat e zbatimit dhe eventalisht financimit u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

Neni 3

1. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i përjashton materialet, automjetet, mallrat dhe pajisjet, si dhe pjesët e këmbimit të lëvruara në kuadër të projektit të përmendur në nenin 1, paragrafi 1, me porosi dhe me shpenzimet e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë nga detyrimet tarifore të importit dhe të eksportit, detyrimet tarifore për licencat, taksat e portit e të magazinimit, dhe nga taksa të tjera publike, sikurse garanton, që materialet të zhdoganohen pa vonesë.

2. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton organizatën zbatuese të projektit nga të gjitha taksat dhe tatimet direkte, që



lindin në Republikën e Shqipërisë nga lidhja dhe zbatimi i kontratave të zbatimit dhe eventualisht financimit të përmendura në nenin 2.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë rimbursen me kërkesën e organizatës zbatuese gjermane vlerën e TVSH-së apo të taksave të ngjashme indirekte, që janë mbajtur në Republikën e Shqipërisë mbi objektet e siguruara dhe shërbimet e kryera në kuadër të lidhjes dhe zbatimit të kontratave të zbatimit dhe eventualisht financimit të përmendura në nenin 2. Taksat mbi konsumin të mbajtura në këtë kontekst merren përsipër prej Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë pas bërjes së kërkesës përkatëse.

4. Kjo marrëveshje vlen si për projektin e përmendur në nenin 1, paragrafi 1, ashtu edhe për masa të tjera vijuese nën të njëjtin titull, nëse qeveritë e dy vendeve tona do të duan të mbështesin më tej projektin. Premtimet financiare të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për masat vijuese të projektit të përmendur në nenin 1, paragrafi 1, bëhen të ditura përmes njoftimesh zyrtare nga ana e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, e cila i referohet tekstualisht kësaj marrëveshjeje.

Neni 4

Edhe për këtë marrëveshje janë të vlefshme dispozitat e marrëveshjes së përmendur në nenin 1, paragrafi 1, të datës 21 tetor 1988, lidhur ndërmjet dy qeverive tona mbi Bashkëpunimin Teknik.

Neni 5

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

2. Kjo marrëveshje lidhet me një afat të pacaktuar. Secila palë kontraktuese mund ta shfuqizojë atë me shkrim në rrugë diplomatike në çdo kohë; shfuqizimi bëhet i efektshëm 30 ditë pasi pala tjetër kontraktuese ka marrë njoftimin përkatës.

3. Palët kontraktuese mund të bien dakord për ndryshime të kësaj marrëveshjeje.

4. Mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen në mirëkuptim mes palëve përmes bisedash apo negociatash.

Bërë në Tiranë, më 27.12.2018, në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS
FEDERALE TË GJERMANISË

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT
SEKSIONI I DYTË

**ÇËSHTJA PULFER KUNDËR
SHQIPËRISË**

(Kërkesa nr. 31959/13)

VENDIM
STRASBURG
20 nëntor 2018

I FORMËS SË PRERË
20.2.2019

*Ky vendim është bërë i formës së prerë, bazuar në
nenin 44§2 të Konventës. Ai mund të bëhet objekt i
rishikimit redaktues.*

Në çështjen Pulfer kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Dytë), e mbledhur si një Dhomë, e përbërë nga:

Robert Spano, *kryetar,*

Julia Laffranque,

Ledi Bianku,

Paul Lemmens,

Jon Fridrik Kjølbro,

Stéphanie Mourou-Vikström,

Ivana Jelić, *gjyqtarë,*

dhe Hasan Bakırcı, *zëvendëssekretar i Seksionit,*

pasi diskutuan me dyer të mbyllura, më datë 16 tetor 2018,

shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

PROCEDURA

1. Çështja filloi me një kërkesë (nr. 31959/13) kundër Republikës së Shqipërisë, paraqitur në Gjykatë me datë 19 prill 2013, mbështetur në nenin 34 të Konventës për Mbrojtjen e të



Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”), nga një shtetase shqiptare, znj. Violeta Pulfer (“kërkuesja”).

2. Kërkuesja u përfaqësua nga znj. A. Kuçani dhe z. G. Çela, avokatë të cilët ushtrojnë detyrën në Tiranë. Qeveria shqiptare (“Qeveria”) u përfaqësua nga agjenti i saj, znj. A. Hicka nga Avokatura e Shtetit.

3. Kërkuesja, veçanërisht, pretendonte se pamundësia e autoriteteve për t’i mbrojtur jetën në mënyrë të shpejtë, shkelte nenet 2 dhe 6 të Konventës. Gjithashtu, ajo ankohej, mbështetur në nenin 8 të Konventës, për një shkelje të së drejtës së saj për t’iu respektuar shtëpia.

4. Më 6 tetor 2014, çështja iu komunikua Qeverisë.

FAKTET

5. Kërkuesja, znj. Violeta Pulfer, është një shtetase shqiptare, lindur në vitin 1967 dhe banuese në Tiranë.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

6. Në një datë të paspecifikuar, në vitin 2011, kërkuesja dhe bashkëshorti i saj u shpërngulën në Vlorë. Ankuesja pranoi të blinte një shtëpi, e cila ishte ndërtuar në mënyrë të paligjshme nga S.N. Ndërkohë, S.N. kishte paraqitur një kërkesë për rregullimin e statusit të paligjshëm të shtëpisë.

7. Më datë 19 tetor 2011, kërkuesja dhe S.N. lidhën një kontratë kapari, në bazë të së cilës kërkuesja depozitoi vetëm më pak se gjysmën e çmimit të shitjes si kapar, ndërsa pjesa tjetër do të paguhej pas zgjidhjes së çështjes së statusit të shtëpisë dhe pas lidhjes së kontratës së shitjes.

8. Më datë 8 dhjetor 2011, kërkuesja u shpërngul në shtëpi, sipas kontratës së kaparit.

A. Nxjerrja e kërkueses me forcë nga shtëpia

1. Përpyekja e parë për t’u nxjerrë nga shtëpia

9. Më datë 12 janar 2012, S.N. i kërkoi kërkueses të lironte shtëpinë. Kërkuesja kundërshtoi të dilte dhe i kujtoi S.N. detyrimet që dilnin nga kontrata e kaparit. Rezulton se në të njëjtën ditë, S.N. shkatërroi edhe një pjesë të pronës së luajtshme të kërkueses.

10. Më 1 shkurt 2012, S.N. dorëzoi një padi civile, ku kërkonte që kontrata e kaparit të deklarohet e pavlefshme dhe që atij t’i lejohej të rimernte pronësinë e shtëpisë.

11. Më 3 maj 2012, Gjykata e Rrethit Vlorë e rrëzoi padinë dhe konstatoi se kontrata e kaparit

ishte e vlefshme dhe e ligjshme. U konstatua edhe se kërkesa për rimarrjen në pronësi e shtëpisë nuk mbështetej në ligj. Duke qenë se ndaj këtij vendimi nuk u paraqit asnjë ankesë, vendimi u bë i formës së prerë më 18 maj 2012.

12. Rezulton se më datë 10 korrik 2012, statusi i shtëpisë u rregullua dhe, si rrjedhojë, S.N. fitoi dokumentet e pronësisë. Rezulton se, në vijim, midis S.N. dhe kërkueses nuk është lidhur asnjë kontratë shitje.

2. Përpyekja e dytë për nxjerrjen nga shtëpia

13. Në mëngjesin e datës 8 shtator 2012, S.N. hyri me forcë në shtëpi. Sipas kërkueses, ai i vendosi një litar në qafë, e tërhoqi zvarrë në tokë dhe e përplasi të muret rrethuese për rreth dhjetë minuta.

14. Në po të njëjtën ditë, kërkuesi i dërgoi mesazhe shefit të policisë dhe prokurorit të rrethit, duke kërkuar mbrojtjen e autoriteteve për të shmangur dhunën e mëtejshme. Ajo paraqiti si prova në Zyrën e Regjistrimit të Gjykatës, disa *screenshot* të mesazheve në fjalë, të marrë nga telefoni i saj celular. Sipas kërkueses, policia ndërhyri pas një orë e gjysmë.

15. Më datë 9 shtator 2012, bashkëshorti i kërkueses vuri re E.N., bashkëshorten e S.N., teksa hiqte vegla dhe objekte nga garazhi i shtëpisë. Në po të njëjtën ditë, kërkuesi shkoi në rajonin e policisë për të dorëzuar një padi penale ndaj S.N., për vjedhje.

16. Rezulton se më datë 10 shtator 2012, kërkuesja shkoi të jetonte në shtëpinë e nënës së saj në Tiranë.

17. Më datë 30 tetor 2012, me ndihmën e policisë, kërkuesja hyri në shtëpi dhe e gjeti atë të boshatisur.

B. Hetimet dhe procedimet penale ndaj S.N.

1. Hetimi i parë dhe grupi i procedimeve

18. Në një datë të paspecifikuar, në janar të vitit 2012, kërkuesja paraqiti një padi penale kundër S.N. për veprën e vetëgjyqësisë, mbështetur në nenin 277 të Kodit Penal (“KP”).

19. Më datë 12 janar 2012, prokurori mori deklaratën e S.N. dhe E.N. për përpyekjet e tyre për të nxjerrë kërkuesen nga shtëpia.

20. Më datë 14 maj 2012, S.N. u akuzua për veprën e vetëgjyqësisë, sipas nenit 277 të KP-së.

21. Më datë 20 qershor 2012, prokurori e dërgonte S.N. në gjyq. Dosja e çështjes iu



transmetua Gjykatës së Rrethit Vlorë, në mënyrë që kjo e fundit të realizonte procedimet.

22. Më datë 12 dhjetor 2012, Gjykata e Rrethit Vlorë vendosi të ndërpriste procedimet, mbështetur në nenin 387 të Kodit të Procedurës Penale (“KPP”), duke qenë se për këtë veprë ishte dhënë amnisti, sipas aktit të përgjithshëm të amnistisë (ligji nr. 107, i datës 8 nëntor 2012 mbi amnistinë).

2. Hetimi i dytë

23. Më datë 8 shtator 2012, kërkuesja dorëzoi një tjetër padi penale ndaj S.N. për veprën e vetëgjyqësisë, mbështetur në nenin 277, të KP-së. Në po të njëjtën ditë, prokurori mori në pyetje S.N. në cilësinë e personit, ndaj të cilit kishte nisur një hetim.

24. Më datë 9 shtator 2012, kërkuesja dha një deklaratë përpara prokurorit duke u ankuar për ngjarjet në datë 8 dhe 9 shtator 2012 (shih paragrafët 13–15 më sipër). Ajo u ankua edhe për E.N. Në po të njëjtën ditë, E.N. u mor në pyetje për këtë ankesë, në cilësinë e personit ndaj të cilit kishte nisur një hetim.

25. Në vijim të agresionit të pretenduar, të datës 8 shtator 2012, më 9 shtator 2012, prokurori urdhëroi që kërkuesja t'i nënshtrohej një kontrolli mjekësor.

26. Më datë 10 shtator 2012, një oficer policie e referoi veprën e vetëgjyqësisë te prokurori.

27. Më datë 10 shtator 2012, kërkuesja u kontrollua një ekspert mjekoligjor. Raporti mjekësor konstatonte shenja të dukshme në qafën e kërkueses, si rezultat i shtrëngimit, si edhe hematoma në kokë si rezultat i goditjes me një objekt të fortë. Dëmtimet e mësipërme e kishin bërë kërkuesen të ishte në një gjendje të përkohshme pamundësie për të punuar, për një periudhë prej nëntë ditësh.

28. Nga dosja e çështjes rezulton se shëndeti i kërkueses filloi të përkeqësohej si rezultat i sulmit të datës 8 shtator 2012. Më pas, ajo kërkoi këshillë mjekësore prej ekspertëve në Greqi.

29. Më datë 14 shtator 2012, prokurori nisi hetimin penal nr. 1473 ndaj S.N. për plagosje të lehtë fizike me dashje dhe vetëgjyqësi sipas neneve 89 dhe 277 të KP-së. Një hetim u hap edhe ndaj E.N. për vetëgjyqësi.

30. Më datë 4 tetor 2012, kërkuesja paraqiti një tjetër padi penale ndaj S.N. për, *inter alia*, veprat e kërcënimit, hyrjes me dhunë, sulmit,

vjedhjes, shkatërrimit të pronës dhe përdorimit me keqdashje të thirrjeve telefonike, sipas neneve 84, 112, 119, 134, 150 dhe 275 të KP-së.

31. Më datë 4 tetor 2012, prokurori nisi hetimin penale nr.1588, ndaj S.N. për veprën e përdorimit me keqdashje i thirrjeve telefonike, sipas nenit 275 të KP-së.

32. Më datë 8 tetor 2012, prokurori vendosi të bashkonte dy hetimet, nr. 1473 dhe 1588.

33. Më 12 tetor 2012, S.N. dha një deklaratë përpara prokurorit.

34. Sipas një certifikate lëshuar nga spitali, më 27 nëntor 2012, tërhequr në Greqi, kërkuesja iu nënshtroa një disketomie serioze të diskut cervical (një operacion për heqjen e diskut të qafës ose diskut degenerativ në zonën e qafës që i përket shpinës) në Greqi. Pas kësaj, asaj iu desh të mbante një qafore për dy muaj.

35. Më 6 dhjetor 2012, pas deklaratës së bërë nga avokati i kërkueses se shëndeti i saj ishte përkeqësuar, dhe se ajo i ishte nënshtroar një operacioni si edhe një imazhimi me rezonancë magnetike për pjesën e qafës, prokurori urdhëroi një kontroll mjekësor nga e para. Avokati paraqiti edhe një listë të detajuar me objektet e kërkueses, të cilat kishin qenë brenda në shtëpi, në shtator 2012.

36. Më 17 janar 2013, ekspertët e mjekësisë ligjore konfirmuan se në trupin e kërkueses ishin gjetur shenja të shtrëngimit në qafë dhe hematoma në kokë, si rezultat i ngjarjeve më 8 shtator 2012, dhe një qepje (si rezultat i një ndërhyrje kirurgjikale). Dëmtimet e mësipërme i kishin krijuar asaj një pamundësi të përkohshme për të punuar, për një periudhë prej nëntë ditësh. Më tej, ata pohonin se mbështetur në dokumentet në dosjen e çështjes, më konkretisht certifikata spitalore e datës 27 nëntor 2012, imazhimit të rezonancës magnetike dhe raportit pas një konsulte me një neuropsikiatër të posaçëm, dëmtimi i konstatuar në imzhimin e rezonancës magnetike, nuk lidhej me ngjarjet e datës 8 shtator 2012; ato ishin shkaktuar si rezultat i kushteve që kishin ekzistuar përpara traumës.

37. Më 15 shkurt 2013, prokuroria konstatoi se S.N. dyshohej të kishte kryer veprat e parashikuara në nenet 89, 275 dhe 277 të KP-së. E.N. dyshohej të kishte kryer veprën e parashikuar në nenin 277 të KP-së. Megjithatë,



prokuroria vendosi të ndërpriste hetimin, duke qenë se ishte dhënë amnisti për veprat e pretenduara, sipas aktit të përgjithshëm të amnistisë. Vendimi i referohej edhe dy kontrolleve mjeko-ligjore të datës 10 shtator 2012 dhe 17 janar 2013. Vendimi, për sa ka lidhje me çështjen, arsyetohet si më poshtë:

“... sipas kontrollit mjekoligjor të datës 10 shtator 2012, u konstatua se dëmet në trup e kishin bërë atë të mos ishte në gjendje të punonte përkohësisht, për më shumë se nëntë ditë.

...

[Kërkuesja] pretendon se ditën e aksidentit, ajo kishte marrë dëmtime serioze fizike, për shkak të tyre asaj iu desh t'i nënshtrohej një ndërhyrje kirurgjikale. Më 6 dhjetor 2012, ajo iu nënshtrova një kontrolli mjekoligjor, i cili u realizua më 17 janar 2013... u konstatua se dëmtimet fizike e kishin bërë atë përkohësisht të mos ishte në gjendje të punonte, për më shumë sesa nëntë ditë. Dëmtimet duhet të shqyrtohen sipas veprës për dëmtim fizik, parashikuar në nenin 89 të Kodit Penal.

...

Në mbështetje të informacionit të marrë gjatë hetimit..., rezultojnë se nga data 24 deri më 27 shtator 2012, S.N. ka shqetësuar Violeta Pulfer me telefonata, dhe e ka kërcënuar për të mos e lejuar të kthehej në shtëpinë të cilën kishte blerë. Në këto rrethana, dyshohet se S.N. dhe E.N. kanë kryer veprën e parashikuar në nenin 277 të Kodit Penal, ndërsa S.N. po ashtu [dyshohet të ketë kryer] veprat e parashikuara në nenet 89 dhe 275 të Kodit Penal...

Më 28 nëntor 2012, [akti i përgjithshëm i amnistisë] hyri në fuqi. Seksioni 5 parashikon ndërprerjen e ndjekjes penale për të gjitha veprat e kryera deri më 30 shtator 2012, për të cilat Kodi Penal parashikon një dënim me burg deri në dy vjet ose një dënim më të lehtë/

...

Veprat e parashikuara në nenet 89, 277 dhe 275 të Kodit Penal, për të cilat janë nisur hetimet, kanë një periudhë maksimale dënimi me burg për dy vjet, dhe janë kryer përpara datës 30 shtator 2012. Në këto rrethana, ka arsye që procedimi penal të mos vijojë.”

38. Kërkuesja paraqiti përpara Prokurorit të Përgjithshëm të Shqipërisë një ankesë ndaj vendimit të prokurorit, i cili i përket datës 15 shkurt 2013. Ajo kërkoi që procedimi të vijonte nga prokurori i rrethit për veprën e vjedhjes në bashkëpunim me të tjerë, shkatërrimit të pronës, torturës dhe ndalimit me anë të kanosjeve dhe të dhunës për të gëzuar të drejtën e njohjes së pronës, sipas neneve 134, 150, 86, 109/b të KP-së, respektivisht. Gjithashtu, ajo u ankua për mungesë të paanshmërisë nga ana e prokurorit.

39. Më 25 prill 2013, ankueses iu dha statusi për paaftësi të plotë dhe u njoh si përkohësisht e paaftë për të punuar.

40. Më 11 korrik 2014, Prokurori i Përgjithshëm e dërgoi dosjen në prokurorinë e rrethit Fier për procedimet në lidhje me ankesën e kërkueses mbi paanshmërinë e prokurorit të rrethit Vlorë.

41. Më 2 dhe 3 nëntor 2017, Qeveria dhe kërkuesi, respektivisht, informuan Gjykatën se kërkuesja kishte paraqitur një ankesë në Gjykatën e Rrethit Vlorë, ndaj vendimit të prokurorit të datës 15 shkurt 2013, sipas nenit 329 të KPP-së.

42. Më 18 maj 2015, Gjykata e Rrethit Vlorë pushoi ankesën e kërkueses. Ajo konstatoi se prokurori kishte ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm procedues dhe se procedimet ishin ndërprerë rregullisht në respektim të aktit të përgjithshëm të amnistisë.

43. Më 15 shtator 2015, Gjykata e Apelit Vlorë pushoi apelimin e bërë nga kërkuesja për të njëjtat arsye të paraqitura edhe nga Gjykata e Rrethit Vlorë. Po ashtu, ajo vërejtë se kërkuesja nuk kishte parashtruar përpara gjykatave vendase faktin se prokuroria kishte pushuar procedimet.

44. Më 14 korrik 2016, Gjykata e Lartë la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit të datës 15 shtator 2015.

3. Hetimi i tretë

45. Në një datë të papërcaktuar, kërkuesja paraqiti një tjetër padi penale ndaj S.N. dhe E.N. për veprën e vjedhjes sipas nenit 134 të KP-së.

46. Më 3 nëntor 2017, kërkuesja bëri me dijeni Gjykatën për rezultatin e procesit të tretë.

47. Më 2 nëntor 2012, prokurori nisi hetimin nr. 1762 ndaj S.N. dhe E.N. për veprën e vjedhjes, sipas nenit 134 të KP-së në lidhje me ngjarjen e datës 30 tetor 2012.

48. Më 6 dhjetor 2012, kërkuesja paraqiti një tjetër kërkesë përpara prokurorit, duke u ankuar, midis të tjerash, për vjedhjen e sendeve të saj personale, më 30 tetor 2012.

49. Më 13 mars 2013, prokuroria e klasifikoi veprën si vetëgjyqësi, sipas nenit 277 të KP-së.

50. Më 10 prill 2014, Gjykata e Rrethit Vlorë ndërpreu procedimet mbështetur në nenin 387 të KPP-së, duke qenë se ishte dhënë amnisti për veprën në mbështetje të aktit të përgjithshëm të amnistisë.

4. Informacione të reja për një proces të katërt dhe grupi i procedimeve

51. Më 3 nëntor 2017, kërkuesja informoi Gjykatën, se në një datë të papërcaktuar, në vitin



2014, ajo kishte paraqitur në prokurorinë Tiranë, një tjetër ankesë ndaj S.N. për veprat e kanosjes, plagosjes së rëndë me dashje dhe të ofendimi, në mbështetje të neneve 84, 88 dhe 119 të Kodit Penal. Kërkesja ishte ankuar edhe për faktin se raporti mjekësor i datës 17 janar 2013 mbështetej në dokumente të falsifikuara dhe se vepra e plagosjes së rëndë me dashje ishte kryer, në fakt.

52. Më 30 qershor 2014, prokurori në Tiranë, pas kryerjes së disa veprimeve hetuese, vendosi të mos e dërgonte çështjen për gjykim me arsyetimin se nuk kishte elementë të krimit. Ai arsyetonte se imazhet e rezonancës dhe konsulta me neuropsikiatrin, të cilat ishte mbështetur raporti mjekësor, nuk kishin lidhje me ngjarjet e datës 8 shtator 2012.

53. Më 3 dhjetor 2014, Gjykata e Rrethit Tiranë, pas kërkesës dërguar nga kërkesja, vendosi ta anulonte vendimin e prokurorit dhe e urdhëroi atë të vijonte me hetimet. Ajo gjykoi se prokurori duhej të shqyrtonte provat e paraqitura nga kërkesja si edhe çdo provë ose pretendim tjetër në lidhje me to, për të realizuar në këtë mënyrë një hetim të plotë.

54. Më 6 tetor 2015, Gjykata e Apelit Tiranë, pas një apelimi të bërë nga prokurori, la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit të datës 3 dhjetor 2014.

55. Në shkurt 2018, Qeveria informoi Gjykatën për zhvillimet e mëtejshme. Më datë 6 dhjetor 2017, prokuroria Tiranë regjistroi procedimet penale për falsifikim dokumentesh. Më 11 dhjetor 2017, prokuroria Tiranë shpalli mungesën e kompetencës dhe ia transferoi çështjen prokurorisë së Vlorës, e cila e regjistroi çështjen nr. 9854, më 14 dhjetor 2017. Rezulton se hetimi po vijon ende. Megjithatë, Qeveria pohoi se ky grup procedimesh nuk kishte asnjë lidhje me ankesat e kërkeses.

II. LIGJI DHE PRAKTIKA PÛRKATËSE VENDËSE

A. Kodi Penal (“KP”)

56. Neni 84 parashikon se kundërvajtja e kanosjes dënohet me burgim deri në një vit.

Neni 88 parashikon se vepra e plagosjes së rëndë me dashje, e cila sjellë si pasojë gjymtimin, shëmtimin ose çdo dëmtim tjetër të shëndetit të personit ose ka qenë e rrezikshme për jetën në çastin e shkakimit të saj, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

Neni 89 parashikon se vepra e plagosjes së lehtë me dashje, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se 9 ditë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 109/b parashikon se vepra e shtrëngimit me anë të kanosjes ose dhunës për përvetësimin e pronës dënohet me burgim deri në tetë vjet.

Neni 112 parashikon se vepra e hyrjes ose e qëndrimit me forcë në pronën e tjetri, dënohet me burgim deri në një vit.

Neni 119 parashikon se vepra e fyerjes dënohet me gjobë deri në 1 milion lekë shqiptarë.

Neni 134§1 parashikon se vepra e vjedhjes dënohet me burgim deri në tre vjet. Nëse kryhet në bashkëpunim me të tjerë, ajo dënohet me burgim deri në pesë vjet (neni 134§2). Në rastin e përdorimit të dhunës, vjedhja dënohet me burgim deri në pesëmbëdhjetë vjet (neni 139).

Neni 150 parashikon se vepra e shkatërrimit të pronës dënohet me burgim deri në tre vjet.

Neni 275 parashikon se vepra e përdorimit me keqdashje të thirrjeve telefonike dënohet me burgim deri në një vit.

Sipas nenit 277, vepra e vetëgjyqësisë, e cila është ushtrimi i një të drejte prej personit që i përket ose që kujton se i përket dhe që nuk njihet nga tjetri pa iu drejtuar organit kompetent shtetëror, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.

B. Kodi i Procedurës Penale (“KPP”)

57. Dispozitat përkatëse të KPP-së, në fuqi në kohën respektive, parashikojnë si më poshtë.

58. Sipas nenit 61, një person i cili ka pësuar dëm nga vepra penale mund të ngrejë padi civile në procesin penal, për të kërkuar shpërblimin e dëmit. Sipas nenit 62§2, padia duhet të dorëzohet përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor. mbështetur në nenin 62§3, gjykata mund të vendosë veçimin e padisë civile dhe dërgimin e saj në gjykatën civile nëse gjykimi i saj vështirëson ose zvarrit procesin penal.

59. Neni 284 parashikon, midis të tjerash, se veprat të cilat shkaktojnë dëm fizik dhe përdorim keqdashës të thirrjeve telefonike, të parashikuara në nenet 89 dhe 275 të Kodit Penal duhet të hetohen nga prokurori vetë nëse pala e dëmtuar ka paraqitur një padi penale. Edhe pse në Kodin Penal nuk ka asnjë dispozitë specifike,



parashikimi në nenin 284 përjashton nga hetimi veprat e tjera të parashikuara në paragrafin 58 më sipër, vetëm në rastin e një padie penale nga pala e dëmtuar. Për këtë arsye, ato mund të ndiqen penalisht nga prokuroria me mocionin e saj.

60. Neni 328§f parashikon të drejtën e prokurorit për të ndërprerë ndjekjen penale, në rastin kur, midis situatave të tjera, kjo gjë parashikohet me ligj. Neni 329 parashikon të drejtën për të apeluar në një gjykatë rrethi kundër vendimit të prokurorit për të ndërprerë hetimin. Në gjykatën e apelit mund të paraqitet një ankesë kundër vendimit të gjykatës së rrethit. Neni 387 i KPP-së parashikon se gjykata e rrethit mund të pushojë çështjen nëse ndjekja penale nuk duhet të nisë ose nuk duhet të vijojë, ose nëse vepra është shuar.

C. Kodi Civil

61. Neni 608 i Kodit Civil parashikon se cilido i cili i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar. Ai ose ajo nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj. Neni 609 parashikon se dëmi duhet të jetë rezultat i veprimit ose mosveprimit të drejtpërdrejtë të një personi. Neni 625 parashikon se personi që pëson një dëm jopasuror ka të drejtë të shpërblehet kur: a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit, të integritetit fizik ose psikik të tij; b) është cenuar nderi, personaliteti ose reputacioni i tij; c) është cenuar e drejta e emrit; ç) është cenuar respektimi i jetës private. Sipas nenit 640, dëmi pasuror që shpërblehet përbëhet nga humbja e pësuar dhe fitimi i munguar. Sipas nenit 641, personi që i ka shkaktuar tjetrit një dëm në shëndetin e tij, detyrohet ta shpërblejë dëmin.

D. Akti i përgjithshëm i amnistisë (ligji nr. 107/2018 i datës 8 nëntor 2012, për amnistinë)

62. Sipas seksionit 5 të aktit të përgjithshëm të amnistisë, një ndjekje penale nuk mund të fillojë ose nëse ka filluar tashmë, ajo duhet të pushohet, për veprat e kryera përpara datës 30 shtator 2012, për të cilat KP-ja parashikon një dënim me burg deri në dy vjet ose dënime të tjera më të lehta.

LIGJI

I. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 3 TË KONVENTËS

63. Kërkuesja u ankua se dështimi i autoriteteve për të mbrojtur jetën e saj, e cila

ishite përballur me rrezik serioz për shkak të akteve të dhunshme të një individi, si edhe pamundësia e autoriteteve për të vijuar ndjekjen dhe procedimet penale ndaj S.N. kishte shkelur nenet 2 dhe 6 të Konventës.

64. Gjykata, ka kompetencën të japë karakteristikat e fakteve të çështjes, konstaton se, në mungesë të një kanosje serioze për jetën e kërkueses, ankesat e mësipërme të lidhura me integritetin e saj fizik do të shqyrtohen në mbështetje të nenit 3 të Konventës (shih *Valiuliené kundër Lituanisë*, nr. 33234/07, §42, 26 mars 2013 dhe *Radomilja dhe të Tjerët kundër Kroacisë* [DHM], nr. 37685/10 dhe 22768/12, §§ 126–127, 20 mars 2018), i cili parashikon si më poshtë:

Neni 3

“Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose degraduese”.

A. PRANUESHMËRIA

1. Parashtrimet e palëve

65. Qeveria parashtroi se procedimet penale në lidhje me falsifikimin e dokumenteve nuk ishin të lidhura me ankesat e kërkueses, sipas neneve 3 dhe 8 të Konventës (shih paragrafët 44–48 më sipër).

66. Qeveria parashtroi se trajtimi, subjekt i të cilit kishte qenë kërkuesja, nuk arrinte nivelin minimal të dhunës për t’u klasifikuar nën objektin e nenit 3 të Konventës. Në lidhje me gjendjen serioze të dëmtimeve të pësuar nga kërkuesja dhe efektet e trajtimit, të ushtruar ndaj saj, Qeveria vëren se dhuna nuk kishte qenë e paramenduar ose e vazhduar, dhe mbështetur në faktin se kërkuesja ishte përfshirë në konfrontim fizik nuk e kishte lejuar situatën të kalonte në ndonjë motiv degradues. Për më tepër, nuk ishte provuar, “përtej dyshimit të arsyeshëm” se kërkuesja ishte përballur me akte që binin në kundërshtim me nenin 3 të Konventës. Përkeqësimi i shëndetit të saj kishte qenë rezultat i konfrontimit midis ankueses dhe S.N.

67. Më tej, Qeveria parashtroi se kërkuesja nuk kishte përdorur mjetet e brendshme të disponueshme. Sidoqoftë, kërkuesja duhej të kishte shfrytëzuar mjetet e brendshme civile. Sipas praktikës ligjore, Qeveria parashtroi se kërkuesja mund të kishte paraqitur një kërkesë për dëmshpërblim, në mbështetje të neneve 608,



625 dhe 640 të Kodit Civil, si edhe vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë, të datës 14 shtator 2007, ose një padi civile në kuadër të procedimeve penale, sipas nenit 61 të KPP-së.

68. Kërkuesja parashtroi se dokumentet në dosjen e çështjes tregonin se ndaj saj ishte përdorur forcë dhe se përkeqësimi i shëndetit të saj ishte rezultat i akteve të dhunshme nga S.N.

69. Në vijim, kërkuesja parashtroi se ajo tashmë kishte përdorur mjetet e mundshme të brendshme. Për këtë arsye, nuk duhej të pritej që ajo të kishte përdorur mjete të tjera të brendshme. Çështja e saj ndryshonte nga praktika gjyqësore e parashtruar nga Qeveria. Për më tepër, ajo nuk i ishte adresuar Gjykatës me një kërkesë të drejtpërdrejtë për kompensim; në të vërtetë ankesa e saj përqendrohej në paaftësinë e Qeverisë për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e saj.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Në lidhje me shterimin e mjeteve të brendshme

70. Në lidhje me kundërshtimin e Qeverisë për mosshfrytëzim të mjeteve të brendshme, Gjykata vëren se për krimet e pretenduara të ishin kryer nga S.N. dhe E.N. ishin hapur të paktën procese penale. I pari dhe i katërti u pushuan me anë të një vendimi gjykate (hetimet e para dhe të treta), dy të tjerët (bashkuar në hetimin e dytë) u pushuan me anë të një vendimit të prokurorit. Të gjitha vendimet u morën duke zbatuar një amnisti të përgjithshme. Më tej, Gjykata vëren se kërkuesja apeloj ndaj vendimit të prokurorit të datës 15 shkurt 2013 (procesi i dytë, i cili ishte i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me ankesën e saj për sulm fizik) tek gjykatat vendëse, por pa efikasitet. Më tej, ajo u ankua te Prokurori i Përgjithshëm. Në lidhje me procesin e pestë (grupi i katërt i procedimeve), Gjykata vëren se pas një apelimi të kërkueses paraqitur në gjykatat vendëse ndaj vendimit të prokurorit për të mos e dërguar çështjen për gjykim, procesi është ende pezull te prokurori. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se kërkuesja tashmë i ka përdorur mjetet e mjaftueshme, në lidhje me procedimet penale, siç parashikohet në ligjin e brendshëm dhe për këtë arsye, ajo e rrëzon kundërshtimin e Qeverisë për këtë aspekt.

71. Në vijim, Gjykata thekson se parandalimi me efikasitet i akteve serioze, të tilla si sulmet e qëllimshme ndaj integritetit fizik të një personi,

ku rrezikohen vlerat themelore dhe aspekte thelbësore të jetës private, kërkon parashikime efikase nga legjislacioni penal. Mjetet civile të referuara nga Qeveria nuk mund të konsiderohen si të mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve të shtetit kontraktues, sipas nenit 3 të Konventës, në raste të tilla si çështja konkrete, sepse ato kanë për qëllim kompensimin më shumë sesa identifikimin dhe dënimin e personave përgjegjës (shih *Sanda Jankovic kundër Kroacisë*, nr. 38478/05, §36, 5 mars 2009; *Beganovic kundër Kroacisë*, nr. 46423/06, §56, 25 qershor 2009; dhe *Remetin kundër Kroacisë*, nr. 29525/10, §76, 11 dhjetor 2012).

72. Për këtë arsye, Gjykata rrëzon kundërshtimin e Qeverisë për këtë aspekt.

b) Në lidhje me faktin nëse kërkuesja është bërë objekt i akteve, të cilët janë në kundërshtim me nenin 3 të Konventës

73. Gjykata vëren se çështja e zbatueshmërisë së nenit 3, është një çështje e juridiksionit të Gjykatës *ratione materiae*, për këtë arsye duhet të respektohet rregulli i përgjithshëm për trajtimin e kërkesave si edhe duhet të kryhet analiza përkatëse për fazën e pranueshmërisë, në rast se nuk ka arsye për ta bashkuar këtë aspekt me themelin. Në çështjen konkrete nuk ekziston asnjë arsye e tillë. Në këtë mënyrë, zbatueshmëria e nenit 3 mbetet të trajtohet në fazën e pranueshmërisë së konventës (shih *Denisov kundër Ukrainës* [DHM], nr. 76639/11, §93, 25 shtator 2018).

74. Gjykata thekson se keqtrajtimi duhet të përkojë me një nivel minimal rreziku, në rast se synohet që të përfshihet në objektin e nenit 3. Vlerësimi i këtij niveli minimal varet nga të gjitha rrethanat e çështjes, të tilla si kohëzgjatja e trajtimit, efektet e tij fizike ose mendore, dhe në disa raste, gjinia, moshja dhe gjendja shëndetësore e viktimës. Gjithashtu, konsideratë i duhet kushtuar edhe kontekstit në të cilin është ushtruar keqtrajtimi, si për shembull atmosfera e një tensioni dhe e mocioneve të forta. Gjykata vlerëson se trajtimi ka qenë “çnjerëzor”, sepse, *inter alia*, ishte i paramenduar, ishte ushtruar për orë të tëra dhe kishte shkaktuar dëmtime fizike ose vuajtje intensive fizike dhe mendore (shih *Valinliene*, cituar më sipër, §65–66 dhe referencat e cituara në të).



75. Duke u rikthyer në rrethanat e çështjes në fjalë, Gjykata vëren se kërkuesja ishte bërë objekt i dhunës. Fillimisht, Gjykata nënvizon dhunën fizike të ushtruar ndaj kërkueses. Siç edhe konfirmohet nga gjetjet e raportit mjekoligjor, te kërkuesja ishin të dukshme shenjat e shtrengimit rreth qafës dhe hematoma në kokë, si rezultat i sulmit. Kërkuesja ishte në pamundësi për të punuar për më shumë se nëntë ditë. Më tej, Gjykata vlerëson se sulmi, në vetvete, mund të ketë krijuar te kërkuesja ndjenjën e pasigurisë, të ankthit dhe të stresit, përderisa ajo kishte frikë të kthehej në shtëpinë ku kishte jetuar më herët për pak muaj. Në lidhje me sa përmendet më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se keqtrajtimi i kombinuar me ndjenjat e frikës dhe të pafuqisë te kërkuesja ishin mjaftueshëm serioze për të përmbushur nivelin e një situatë serioze sipas nenit 3 të Konventës dhe në këtë mënyrë çon në detyrimin pozitiv të Qeverisë, sipas këtij parashikimi (po këtu, §70).

c) Përfundim

76. Gjykata konstaton se ankesa, në mbështetje të nenit 3 të Konventës nuk është haptazi e pambështetur në fakte, sipas interpretimit të nenit 35§3 të Konventës. Në vijim ajo konstaton se ajo nuk është e papranueshme për ndonjë arsye tjetër. Prandaj, ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Themeli

1. Parashtrimet e palëve

77. Në parashtrimin e saj kërkuesja, shpjegonte se prokurori kishte filluar hetimin penal ndaj S.N. vetëm për shkaktimin e dhunës fizike, vetëgjyqësi dhe përdorimin keqdashës të thirrjeve telefonike, edhe pse ajo kishte paraqitur padi penale për vrasje të mbetur në tentativë, vjedhje përmes ushtrimit të dhunës, hyrjes me dhunë dhe shkatërrimit të pronës, sipas neneve 76, 139, 112 dhe 150 të Kodit Penal. Në parashtrimet e saj fillestare dhe në ato shtesë, të datës 3 nëntor 2017, kërkuesja deklaroi se ajo kishte ndërmarrë procedura për vërtetësinë e raportit mjeko-ligjor, të datës 17 janar 2013, me argumentin se ndaj saj ishin kryer vepra më të rënda sesa shkaktimi i dëmit fizik. Ajo kishte marrë statusin e paafëtisë së plotë, dhe përkeqësimi i shëndetit kishte qenë rezultat i dhunës që S.N. kishte përdorur ndaj saj.

78. Qeveria parashtroi se kuadri ligjor në nivel të brendshëm kishte ofruar një kuadër të mjaftueshëm rregullator për të ndjekur në mënyrë penale aktet e dhunshme të pretenduara nga kërkuesja. Autoritetet vepruan me kujdesin e duhur. Hetimet dhe procedimet penale që pasuan kishin qenë mjaftueshëm efikase, të shpejta dhe të suksesshme. Përdorimi i mjeteve të legjislacionit penal nga kërkuesja nuk kishte pasur sukses për arsye të cilat nuk vareshin nga veprimet e autoriteteve.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Parimet e përgjithshme për detyrimet pozitive të shtetit, të zbatueshme në çështjen konkrete

79. Gjykata thekson se masat efikase parandaluese ndaj akteve të rënda, të tilla si ato në çështjen në fjalë, mund të arrihen vetëm me anë të ekzistencës së dispozitave efikase në legjislacionin penal, të mbështetura nga makineria ligjzbatuese (*X dhe Y kundër Holandës*, 26 mars 1985, §27 seritë A, nr. 91, *Beganović*, cituar më sipër, §71, *Mahmut Kaya kundër Turqisë*, nr. 22535/93, §115, GJEDNJ 2000–III dhe *M.C. kundër Bullgarisë*, nr. 39272/98, §150, GJEDNJ 2003–XII).

80. Për më tepër, është i vetëkuptueshëm fakti se detyrimi ndaj shtetit, sipas nenit 1 të Konventës, nuk mund të interpretohet si një kërkesë ndaj shtetit që me anë të sistemit të tij ligjor të garantojë që një individ të mos ushtrojë trajtim çnjerëzor ose degradues, ose nëse një gjë e tillë ndodh, procedimet penale duhet të çojnë detyrimisht drejt një sanksioni të caktuar. Në mënyrë që shteti të mbajë përgjegjësinë, sipas Gjykatës, duhet të tregohet se sistemi i brendshëm ligjor, dhe veçanërisht ligji penal i zbatueshëm në rrethanat e çështjes, dështon të ofrojë mbrojtje praktike dhe efikase për të drejtat të cilat garantohen me anë të nenit 3 (shih *Beganović*, cituar më sipër, §71, dhe *Valinliene*, cituar më sipër, §75).

81. Në këto rrethana, duhet të shtohet se nuk është detyrë e Gjykatës të verifikojë nëse prokurorët dhe gjykatat vendëse kanë zbatuar ligjin penal vendës në mënyrë korrekte. Ajo çfarë diskutohet në çështjen konkrete nuk është problemi i legjislacionit penal, por përgjegjësia e shtetit sipas Konventës. Gjykata duhet të respektojë zgjedhjen e masave të duhura nga gjykatat vendëse, duke ruajtur në të njëjtën kohë



pushtetin për të shqyrtuar dhe për të ndërhyrë në çështjet me dispropocion të dukshëm midis nivelit se sa i rëndë ka qenë akti dhe rezultateve të arritura në nivel vendës (shih, *mutatis mutandis*, *Nikolova dhe Velichkova kundër Bullgarisë*, nr. 7888/03, §62, 20 dhjetor 2007; *Atalay kundër Turqisë*, nr. 1249/03, §40, 18 shtator 2008; dhe *Valiuliene*, cituar më sipër, §76).

82. Sipas karakterit absolut të së drejtës së garantuar, Gjykata nuk e përjashton mundësinë se neni 3 i Konventës mund të zbatohet edhe kur rreziku shkaktohet nga persona ose grupe personash, të cilët nuk janë zyrtarë publikë. Megjithatë, duhet të provohet se rreziku është real dhe se autoritetet e shtetit përkatës nuk kanë mundësi ta shmangin rrezikun duke garantuar mbrojtjen e duhur (shih, *mutatis mutandis* *H.L.R. kundër Francës*, 29 prill 1997, §40, *raportet e vendimeve dhe e vendimeve* 1997–III).

83. Për më tepër, amnistia ose falja nuk pajtohet me detyrën e shtetit për të hetuar aktet e keqtrajtimit dhe për të luftuar pandëshkueshmërinë (shih, *mutatis mutandis*, *Abdilsamet Yaman kundër Turqisë*, nr. 32446/96, §55, 2 nëntor 2004; dhe *Ateşoğlu kundër Turqisë*, nr. 53645/10, §25, 20 janar 2015). Gjykata vlerëson se ky parim zbatohet në rastin e akteve midis individëve privatë për aq sa trajtimi arrin pragun, sipas nenit 3 të Konventës.

a) Zbatimi i parimeve të mësipërme në çështjen konkrete

84. Gjykata vlerëson në fillim se për sa u përket mekanizmave të legjislacionit penal, të parashikuar nga sistemi ligjor shqiptar në lidhje me detyrimet e shtetit, sipas nenit 3 të Konventës, Kodi Penal përcakton si specifike veprat të cilat shkaktojnë dëmtime fizike dhe dëmtime të rënda fizike. Vepra e shkakutimit të dëmtimit fizik, sipas nenit 89 të KP-së, hetohet nga një prokuror vetëm pas paraqitjes së një kërkesë nga pala e dëmtuar, ndërsa për veprën e shkakutimit të dëmtimit të rëndë serioz, sipas nenit 88 të KP-së, prokuroria ruan të drejtën të hapë hetim penal me mocionin e vet. Për më tepër, Gjykata vërejt se edhe vepra të tjera ngarkuar S.N.-së nga kërkuuesja, si për shembull përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike, kanosja, vetëgjyqësia dhe të tjera, sipas Kodit Penal parashikohen si vepra specifike. Për këtë arsye, Gjykata pranon se ligji shqiptar ka

garantuar një kuadër të mjaftueshëm rregullator për të ndjekur penalisht krimet atribuar S.N.-së nga kërkuuesja.

85. Megjithatë, sipas parimit se Konventa nuk ka për qëllim të garantojë të drejtat teorike apo ato të mbështetura në iluzione, por të garantojë të drejtat praktike dhe efikase, Gjykata duhet të sigurohet se detyrimi i shtetit për të mbrojtur të drejtat e personave nën juridiksionin e tij, përmbushte në mënyrën e duhur në praktikë (shih, *Ž. B. kundër Kroacisë*, nr. 47666/13, §59, 11 korrik 2017). Për këtë arsye, Gjykata tashmë duhet të shqyrtojë nëse mënyra se si u përdorën mekanizmat e legjislacionit penal në çështjen në fjalë, kishte të meta deri në pikën saqë mund të përbënte një shkelje në këndvështrimin e detyrimeve të shtetit të paditur, sipas nenit 3 të Konventës (shih, *Valiuliene*, cituar më sipër, §79, dhe, *mutatis mutandis*, *Bălșan*, cituar më sipër, §64).

86. Gjykata vlerëson se gjatë hetimeve të para, të dyta dhe të treta, prokurori hapi një hetim penal dhe ndërmori një sërë masash procedurale. Megjithatë, hetimet dhe procedimet përkatëse u ndërprejnë sipas një amnistie të përgjithshme. Për pasojë, autori (autorët) i krimit i krimeve të pretenduara nuk u gjykuan.

87. Duke iu kthyer çështjes së përgjegjësisë së shtetit, sipas nenit 3 të Konventës, Gjykata fillimisht, përsërit se, brenda kufijve të Konventës, zgjedhja e mjeteve për të siguruar përputhshmërinë me nenin 3 në sferën e marrëdhënieve të individëve midis njëri-tjetrit, në parim, është një çështje që kategorizohet në marginën e vlerësimit të autoriteteve të brendshme, në rast se mekanizmat e legjislacionit penale janë të disponueshëm për viktimën (shih, *Beganović*, cituar më sipër, §86). Në këtë mënyrë, dhe për sa ka të bëjë me rrethanat e çështjes në fjalë, nuk i takon Gjykatës të spekulojë nëse prokurori duhet të kishte ndjekur hetimet penale sipas neneve të tjerë të Kodit Penal siç sugjerohet nga kërkuuesja (shih paragrafët 31 dhe 77 më sipër, dhe *Valiuliene*, cituar më sipër, §85). Në këto rrethana, është e faktuar se rrethanat e çështjes konkrete nuk u provuan kurrë nga një gjykatë kompetente. Në këtë aspekt, Gjykata vërejt se një nga qëllimet për ushtrimin e sanksioneve penale është të kufizohet dhe të parandalohet autori i krimit nga shkaktimi i dëmeve të mëtejshme. Më tej, Gjykata vlerëson



se në rastet e torturës ose keqtrajtimit, amnistitë dhe faljet nuk duhet të tolerohen (shih *Mocanu dhe të Tjerët kundër Rumanisë* [DHM], nr. 10865/09, dhe 2 të tjerë, §326, GJEDNJ 2014 (ekstrakte). Në këtë aspekt, Gjykata arrin në përfundimin se edhe pse kuadri ligjor në fuqi mund të ketë pasur një efekt mjaftueshëm parandalues, ku ky i fundit u shua me anë të ligjit për amnistinë.

88. Gjykata vëren se kërkesja u përpoq të shuante efektet e kundërta, të cilat erdhën si rezultat i dhënies së amnistisë së përgjithshme, duke paraqitur një ankesë tjetër ndaj S.N. në vitin 2014, për, midis veprave të tjera, kanosjen dhe shkaktimin e dëmeve të rënda fizike, ku kjo e fundit dënohet me burg deri në dhjetë vjet. Gjykata thekson se prokurori mori masa të menjëhershme për të nxjerrë S.N. përpara drejtësisë. Megjithatë, duke pasur parasysh mungesën e të dhënave, ai vendosi të mos e çonte çështjen në gjykatë. Në vijim të apelimeve të vazhdueshme nga kërkesja, gjykatat vendase e anuluan vendimin e prokurorit për mungesë detajimesh (shih paragrafët 51–55, më sipër). Po ashtu, Gjykata vëren se u ndoqën penalisht vetëm veprat e lehta.

89. Në vijim, Gjykata thekson se pasi gjykatat vendase kishin vendosur ta dërgonin çështjen te prokurori për hetim të mëtejshëm, ky i fundit nuk kishte marrë ende një vendim.

90. Sipas gjykimit të Gjykatës, mënyra në të cilën mekanizmat e legjislacionit penal të cilët u zbatuan në çështjen në fjalë, specifikisht, zbatimi i amnistisë së përgjithshme, që rezultoi në ndërprerjen e tre hetimeve penale të para ndaj agresorit të pretenduar, ishte me të meta, deri në pikën që përbënte një shkelje të detyrimeve pozitive të shtetit përkatës, sipas Konventës në lidhje me pretendimet e kërkeses për sulm. Për këtë arsye, Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të nenit 3 të konventës.

III. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 8 TË KONVENTËS

91. Kërkesja u ankua edhe për një shkelje të së drejtës së saj për respektimin e shtëpisë, jetës dhe pronës së saj, sipas nenit 8 të Konventës, i cili për sa ka të bëjë me rastin konkret parashikon:

Neni 8

“Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.”

92. Në parashtrimet e saj, kërkesja thekson se autoritetet nuk kishin mundur të mbronin shëndetin, jetën dhe pronën e saj, sipas nenit 8. Deri më sot, kërkesja nuk e ka informuar Gjykatën, nëse ajo ka mundur të hyjë në shtëpi.

93. Gjykata, e cila është kompetente për specifikimin e fakteve të çështjes, sipas ligjit, konstaton se kjo ankesë lidhet me integritetin fizik dhe psikologjik të kërkesit i cili lidhet me konceptin e jetës private, sipas nenit 8 të Konventës (shih *Remetin*, cituar më sipër, §90).

94. Gjykata vlerëson se, përderisa ankesa e kërkeses, sipas nenit 8 të Konventës mbështetet në të njëjtat fakte, duhet të deklarohet edhe e pranueshme.

95. Në lidhje me përfundimin e Gjykatës për shkeljen e nenit 3 të Konventës dhe për faktin se kërkesja nuk mundi t'i përgatiste ankesat e saj sipas nenit 8 të Konventës, edhe pas komunikimit të çështjes Qeverisë, Gjykata konstaton se nuk është e nevojshme që ankesa të shqyrtohet veçuar, për sa i përket nenit 8 të Konventës.

IV. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

96. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

97. Kërkesja nuk paraqiti kërkesë për shpërblim të drejtë. Gjykata konstaton se nuk ka asnjë kërkesë për ta adresuar çështjen me mocionin e saj.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA,

1. *E deklaron* kërkesën të pranueshme;
2. *Vendos* në mënyrë unanime, se është shkelur neni 3 i Konventës;
3. *Vendos* me gjashtë vota pro dhe një kundër se nuk ka nevojë të shqyrtohet ankesa, në këndvështrim të nenit 8 të Konventës.

Hartuar në anglisht dhe shpallur me shkrim më 20 nëntor 2018, sipas rregullit 77§2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

Hasan Bakirci
ZËVENDËSSEKRETAR

Robert Spano
KRYETAR



Sipas nenit 45§2 të Konventës dhe rregullit 74§2 të rregullores së Gjykatës, opinioni pjesërisht dakordësues dhe pjesërisht mospajtues i gjyqtarit Lemmens i është bashkëngjitur këtij vendimi.

R.S.
H.B.

OPINIONI PJESËRISHT DAKORDËSUES DHE PJESËRISHT MOSPAJTUES I GJYQTARIT LEMMENS

1. Jam i lumtur të dakordësohem me gjetjen se është shkelur neni 3 i Konventës. Megjithatë, teksa shumica thekson efektet e aktit të përgjithshëm të amnistisë të vitit 2012 për procedimet penale ndaj autorëve të krimit për aktet për të cilat kërkuesja është ankuar, unë jam i mendimit se duhet të ishte treguar më shumë vëmendje ndaj rolit të luajtur nga prokurori në këtë çështje.

Për sa u përket ankesave drejtuar në mbështetje të nenit 8, me keqardhje mund të them sa nuk mund të dakordësohem me këndvështrimin e shumicës, se ato lidhen vetëm me integritetin fizik dhe psikologjik të kërkueses. Në vijim, unë nuk jam dakord me përfundimin e shumicës, se këto ankesa nuk ia vlejnë të shqyrtohen në mënyrë të ndarë.

Pjesa procedurale e nenit 3

2. Në lidhje me pjesën procedurale të nenit 3, unë jam dakord me vlerësimin se kuadri i legjislacionit penal ka një efekt mjaftueshëm parandalues (shih paragrafin 84 të vendimit). Problemi në çështjen konkrete gjendet në zbatimin e këtij kuadri.

3. Në lidhje me tre hetimet e para, më tërheq vëmendjen mënyra se si prokurori ka trajtuar ankesat e kërkueses. kur ka pasur mundësi, në mënyrë sistematike, ai ka zgjedhur veprat me dënime më të ulëta. Si rezultat, procedimet u ndërprejnë të gjitha me justifikim se ishin pjesë e objektit të aktit të përgjithshëm të amnistisë (i cili zbatohet për veprat për të cilat dënimi ishte me burgim prej dy vjetësh ose më i ulët):

a) hetimi i parë: ankesë (vetëm) për veprën e vetëgjyqësisë (dënimi maksimal: tre muaj burg) – akuzë bazuar atë vepër (asnjë specifikim nga prokurori si një vepër më e rëndë!) – procedime të ndërprera në përputhje me rrethanat, për shkak të

amnistisë së përgjithshme (shih paragrafët 18–22 të vendimit);

b) hetimi i dytë: një ankesë për veprën e vetëgjyqësisë, pas së cilës, prokurori nisi një hetim penal për veprat e shkakimit të dëmit fizik (dënimi maksimal: dy vjet burg) dhe vetëgjyqësisë (shih më sipër) – një tjetër ankesë, *inter alia*, për veprat e kanosjes (dënimi maksimal: një vit burg), fyerjes (dënimi maksimal: një gjobë), vjedhjes (dënimi maksimal: tre vjet burg), shkatërrimit të pronës (dënimi maksimal: tre vite burg) dhe përdorimit me keqdashje të thirrjeve telefonike (dënimi maksimal: një vit burg), pas së cilës, prokurori hapi një hetim tjetër penal për përdorimin keqdashës të thirrjeve telefonike – pasi u bashkuan dy hetime, prokurori arriti në përfundimin se S.N. dhe E.N. kishin kryer veprat e dëmtimit fizik, vetëgjyqësisë dhe kërcënimit – procedime të ndërprera për shkak të amnistisë së përgjithshme – apeline nga kërkuesja, e cila u ankua se prokurori nuk kishte vijuar hetimin për veprën e vjedhjes në bashkëpunim me të tjerët (dënimi maksimal: pesë vite burg), shkatërrimin e pronës (shih më sipër), torturës (dënimi maksimal: dhjetë vjet burg) dhe izolimit me anë të kanosjes ose dhunës për njohjen e pronës (shih më sipër) – vendimi për ndërprerjen u la në fuqi nga gjykatat (shih paragrafët 23–44 të vendimit);

c) hetimi i tretë: ankesa për vjedhje (shih më sipër) – hetimi për atë vepër, por më vonë vepra u rispecifikua dhe u bë akuzë për veprën e vetëgjyqësisë (shih më sipër) – procedimet u ndërprejnë, sipas rrethanave për shkak të amnistisë së përgjithshme (shih paragrafët 45–50 të vendimit).

Shumica gjykon se “nuk i takon Gjykatës të spekulojë, nëse prokurori duhej të kishte ndjekur hetimet penale mbështetur në nene të tjerë të Kodit Penal” (shih paragrafin 87 të vendimit). Për mua ky është një qëndrim i pakënaqshëm për rrethanat e çështjes. Gjykata duhej të kishte vijuar më tej dhe duhej të kishte analizuar arsyet, nëse do të kishte ndonjë të tillë, se përse prokurori as nuk u përpoq të ngrinte akuza për veprat për të cilat nuk do të zbatoheshin akti i përgjithshëm i amnistisë.

4. Më pas vjen hetimi i katërt. Ashtu siç shprehet shumica, “kërkuesja u përpoq të përmirësonte efektet e kundërta të cilat vinin nga dhënia e amnistisë së përgjithshme duke dorëzuar një ankesë tjetër ndaj S.N., në vitin 2014, për –



midis veprave të tjera – kanosje dhe shkaktim të dëmtimit të rëndë fizik, ku ky i fundit dënohej me burg deri në dhjetë vjet” (shih paragrafin 88 të vendimit).

Megjithatë, në vend që të kapte mundësinë për të hetuar çështjen, prokurori vendosi të mos e dërgonte çështjen për gjykim “duke pasur parasysh mungesën e provave” (po aty). Këtë herë, gjykata kundërshtoi. Ajo e anuloi vendimin e prokurorit. Që prej asaj kohe, nuk është bërë asnjë përparim (shih paragrafët 51–55 të vendimit).

5. Për këtë arsye, unë mendoj se është ndjekur një rrugë shqetësuese për minimizimin e rëndësisë së fakteve, dhe në këtë mënyrë, u ndoqën penalisht vetëm veprat e lehta, ndërsa veprat e rënda, relevanca e të cilave për mua është e dukshme, nuk u ndoqën penalisht. Nuk duhet kritikuar vetëm akti i përgjithshëm i amnistisë, por edhe - çfarë është edhe më e rëndësishme – specifikimi i akteve penale nga prokurori, në një mënyrë të tillë, që ato të përfshiheshin në fushën e veprimit të aktit. Çështja është një shembull i qartë i mënyrës së si efekti parandalues i kuadrit legjislativ penal është shkatërruar plotësisht.

Neni 8

6. Në lidhje me ankesën e paraqitur nga kërkuesja, sipas nenit 8, shumica gjykon se ajo ka të bëjë me pretendimin për mosrespektim të “shtëpisë, jetës dhe pronës” së saj (shih paragrafin 91 të vendimit) dhe se në parashtrimet e saj, kërkuesja ankohej specifikisht për dështimin për të “praftur shëndetin, jetën dhe pronën e saj” (shih paragrafin 92 të vendimit). Shumica është me mendimin se ankesa “lidhet me integritetin fizik dhe psikologjik të kërkueses”, i cili mbulohet me konceptin e jetës private, sipas nenit 8 (shih paragrafin 93 të vendimit). Duke theksuar në vijim se Gjykata tashmë kishte konstatuar shkelje sipas nenit 3, shumica konstaton se nuk është e nevojshme të shqyrtohet ankesa në mënyrë të veçantë, sipas nenit 8.

7. Me respekt, unë nuk jam dakord.

Për shqyrtimin e ankesave, kërkesa, sipas formulimit në formularin e kërkesës, duhet të jetë pika e nisjes (shih *Radomilja dhe të Tjerët kundër Kroacisë* [DHM], nr. 37685/10 dhe 22768/12, §122, 20 mars 2018). Kërkuesja u ankua për dështimin e autoriteteve në mbrojtjen e jetës,

shëndetit dhe të pronës së saj. Përveç ankesave në lidhje me integritetin e saj fizik dhe psikologjik, të cilin Gjykata, në mënyrë unanime, vendosi ta shqyrtonte sipas nenit 3, kishte ankesa edhe në lidhje me pamundësinë e autoriteteve për ta ndihmuar atë në garantimin e zbatimit të vendimit të Gjykatës së rrethit Vlorë, për të rrëzuar kërkesën e S.N. për rimarrjen e pronësisë së shtëpisë (shih paragrafin 11 të vendimit), dhe duke e lejuara atë, në këtë mënyrë, që të jetonte në shtëpinë e saj. Ankesë u bë edhe për dështimin në mbrojtjen e saj ndaj heqjen e objekteve të saj në shtëpi nga S.N. dhe E.N. (shih paragrafët 15 dhe 17 të vendimit).

Sipas mendimit tim, këto ankesa të tjera kanë të bëjnë me të drejtën për t’iu adresuar një gjykatë (neni 6§1), me të drejtën për respektimin e shtëpisë së kërkueses (neni 8) dhe me të drejtën për respektimin e pronës së saj (neni 1 i protokollit nr. 1).

Konstatimi i shkeljes së nenit 3 nuk konsiderohet se mbulon këto ankesa.

Më vjen keq që këto ankesa, të rispecifikuara sipas parashikimeve të përmendura të Konventës nuk iu komunikuan Qeverisë. Siç duket, kërkuesja nuk ishte në pozitën për të parashtruar kërkesat e sipërpërmendura “edhe pasi çështja iu komunikua Qeverisë” (siç përmendet nga shumica në paragrafin 95 të vendimit), përderisa palëve nuk iu kërkua të paraqisnin vërejtje për to.

Për këto arsye, mendoj se ankesat në lidhje me të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës, të drejtën për respektimin e shtëpisë së kërkueses dhe të drejtën për respektimin e pronës së saj do të duhej të ishin shqyrtuar në mënyrë të veçantë, nëse do të ishte e nevojshme, pasi kjo pjesë e kërkesës t’i komunikohet Qeverisë.

VENDIM

Nr. 41, datë 15.3.2019

MBI RRËZIMIN E KËRKESËS SË OST SHA, MBI NEVOJËN E NDËRRHYRJEVE NË RRJETIN E TRANSMETIMIT

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 60, pika, pika 3, germa “c” dhe pikat 4, 6, 7, 8, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-



s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.3.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike mbi kërkesën e OST sh.a., mbi nevojën e ndërhyrjeve në rrjetin e transmetimit,

konstatoi se:

- Shoqëria OST sh.a., me shkresën e saj nr. 8848 prot., datë 28.12.2018, protokolluar në ERE me nr. 8 prot., datë 3.1.2018, ka paraqitur kërkesën e saj “Mbi nevojën e ndërhyrjeve në rrjetin e transmetimit”.

- Në këtë shkresë, OST sh.a., përmend linja të tensionit të lartë 110 kV dhe nënstacione 110 kV, të cilat pjesërisht janë pjesë e planit 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit. Këto investime, si dhe të reja të paparashikuara në planin e zhvillimit nuk janë kryer pasi prezumohet të kenë kosto të konsiderueshme rreth 100,000,000 euro.

- Projektet e propozuara nuk paraqiten me zëra të detajuar të kostove të secilit projekt, por është dhënë një kosto totale. Është e paqartë se mbi cilën analizë financiare është mbështetur konkludimi në koston e referuar.

- OST sh.a. bën me dije se ndodhet në kushte të mundësive të kufizuara financiare për të kryer një ndërhyrje financuese me fondet e veta në përmasat që ky projekt kërkon dhe pretendon se mundësia e vetme që shoqëria ka, është që të financojë zhvillimin e projektit me fonde të huazuara, duke i kërkuar shoqërisë që do të kontraktohet të ofrojë gjithashtu edhe financimin e projektit nëpërmjet një kredie tregtare me një kohëzgjatje rreth 15 vjet.

- OST-ja pretendon se në këtë mënyrë, mund të përballojë investimet e mësipërme por nuk paraqet argumente në lidhje me koston financiare të kësaj mënyre financimi.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 212, datë 28.12.2017 ka vendosur:

1. Të miratojë planin dhjetëvjeçar 2015–2025 të zhvillimit të rrjetit të transmetimit.

2. OST sh.a., duhet të përditësojë çdo vit planin dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit, sipas kritereve të përcaktuara në “Rregulloren e procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 135, datë 6.9.2017.

- Pjesë e planit të zhvillimit të rrjetit të transmetimit 2015–2025, kanë qenë vetëm 4

projekte për linjat 110 kV, të cilat përfshihen në shkresën nr. 8848 prot., datë 28.12.2018 të OST sh.a., me të cilën është drejtuar kërkesa në ERE.

- Neni 60, pika 1, pika 3, germa “c”, pika 4, pika 6 dhe pikat 7, 8, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, përcaktojnë:

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit harton një plan dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit, në konsultim me palët e interesuara, dhe e paraqet për miratim në ERE.

3. Plani i zhvillimit të rrjetit duhet të përmbajë:

c të gjitha investimet e miratuara dhe të identifikojë investimet e reja, të cilat duhet të zbatohen në tri vitet e ardhshme;

4. ERE shqyrton planin dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit dhe në rast se vëren se nuk janë përmbushur kushtet e përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, kërkon nga Operatori i Sistemit të Transmetimit të plotësojë dhe/ose të ndryshojë planin e tij dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit.

6. Kur ERE konstaton se Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk ka realizuar për tre vite, një investim të parashikuar sipas planit 10-vjeçar, dhe gjykon se investimi është i nevojshëm dhe mund të financohet pa penguar operimin normal të rrjetit, i kërkon atij të marrë një nga këto masa: a) të realizojë investimin në fjalë; b) të organizojë një procedurë konkurruese për realizimin e investimit në fjalë, të hapur ndaj çdo investitori; c) të pranojë rritjen e kapitalit, me qëllim financimin e investimeve të nevojshme.

7. Kur ERE merr masa, sipas shkronjës “b”, të pikës 6, të këtij neni, mund të detyrojë Operatorin e Sistemit të Transmetimit të zbatojë një ose më shumë nga alternativat e mëposhtme:

a) të sigurojë financimin nga ndonjë palë e tretë; b) të kërkojë ndërtimin nga ndonjë palë e tretë; c) të administrojë asetet e reja pas ndërtimit. Në këto raste tarifat përkatëse do të mbulojnë kostot e investimeve në fjalë.

8. ERE, në ushtrimin e kompetencave të parashikuara në pikat 1, 6 dhe 7, të këtij neni, duhet të marrë mendimin nga ministri përgjegjës për energjinë.

- OST sh.a. nuk është në kushtet e një investimi të planifikuar më parë e të përcaktuar.

- Miratimi nga ERE me qëllim sigurimin e një



financimi të jashtëm për realizimin e një investimi, lidhet ekskluzivisht me një investim të planifikuar por të porealizuar.

- Çdo kërkesë për rishikimin e planit dhjetë vjeçar të investimeve, duhet të paraqitet e mbështetur në një analizë tekniko-ekonomike, që bën të qartë rëndësinë e këtyre projekteve në mënyrë që të vlerësohet ndikimi i tyre në konsumatorët fundorë, si dhe mënyra e mbulimit të shpenzimeve të marrjes së kredive të mundshme tregtare.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rrëzojë kërkesën e shoqërisë OST sha, si të pambështetur në ligj.

2. OST sha. të adresojë kushtet e pamundësisë financiare për realizimin e investimeve të parashikuara në planin dhjetëvjeçar, në përditësimin e përvitshëm të planit dhjetëvjeçar të cilin ka detyrimin ta paraqesë në ERE, mbështetur në parashikimet e vendimit të bordit të ERE-s nr. 212, datë 28.12.2017.

3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrotjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sha për vendimin e Bordit të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi

VENDIM

Nr. 42, datë 15.3.2019

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN SHKURT 2019

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë

elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, i ndryshuar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 144, datë 25.6.2018 “Mbi rishikimin e “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 15.3.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” për muajin shkurt 2019.

konstatoi se:

- OSHEE sh.a., me shkresën nr. 4597 prot., datë 25.2.2019 paraqiti në ERE aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin shkurt 2019. Nëpërmjet këtij aplikimi, OSHEE sh.a. kërkon që çmimi i shitjes së energjisë elektrike të klientët e FMF-së për muajin shkurt 2019 të jetë 13.89 lekë/kWh.

- Informacioni i dërguar në këtë shkresë është përgatitur në mbështetje të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 144, datë 25.6.2018 “Mbi rishikimin e “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, neni 8 i rishikuar i “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017.

- OSHEE sh.a. ka përcaktuar çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin shkurt 2019, si vijon:



Çmimi i FMF për muajin Shkurt 2019		Njësia	Aplikimi i OSHEE sh.a.
a	Çmimi maksimal i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me perparesi	Leke/kWh	9.56
b	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.29
c	Çmimi maksimal i blerjes në periudhën relevante	Leke/kWh	9.85
d	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësive së Fundit	Leke/kWh	1.79
e	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75
f	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50
Çmimi i energjisë (c+d+e+f)		Leke/kWh	13.89

- Shoqëria OSHEE sh.a., bashkëlidhur këtij aplikimi, në mënyrë të përmblendhur ka paraqitur informacion mbi realizimin e procedurave të blerjes së energjisë elektrike, nga tregu i parregulluar.

- Çmimi më i lartë i realizuar për muajin shkurt 2019, është çmimi prej 76.95 euro/MWh për blerjen e sasisë prej 15,288 MWh nga shoqëria GSA sh.p.k., për fashën orare 0:00–24:00 në periudhën 1.2.2019–7.2.2019 (lot 2). Për rrjedhojë, çmimi 76.95 euro/MWh propozohet të konsiderohet për përcaktimin e çmimit për klientët FMF-ja për muajin shkurt.

- Sipas informacionit të shoqërisë OSHEE sh.a., për realizimin e procedurave të blerjes së energjisë elektrike në tregun e parregulluar, data 30.1.2019, është data kur kompania ofertuese GSA sh.p.k. (çmimi më i lartë) ka dalë fituese në fazën përfundimtare të negocimit. Data 30.1.2019 duhet të konsiderohet për përcaktimin e kursit të këmbimit EUR/lekë. Sipas publikimeve në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë, rezulton që kursi i këmbimit i përdorur në llogaritjen e çmimit të FMF-së, për 30.1.2019 1 EUR=124.60 LEK.

- Vërehet se në këtë aplikim për çmimin FMF për muajin shkurt 2019, OSHEE sh.a. ka zbatuar me korrektësi përcaktimet e nenit 8 të Metodologjisë për sa i përket çmimit maksimal të blerjes.

- OSHEE sh.a. bazuar në Metodologjinë e Llogaritjes së Çmimit (FMF) ka paraqitur vlerësimin për kostot administrative (CA) prej 1,79 lekë/kWh për llogaritjen e çmimit FMF-35 kV për muajin shkurt 2019, i cili konsiderohet i arsyeshëm dhe është pranuar në llogaritjet e ERE-s.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit, miratur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 266, datë 21.12.2018 “Mbi përcaktimin e tarifës së

shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga shoqëria OST sh.a. për vitin 2019”, është 0.75 lekë/kWh.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV, miratur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 268, datë 21.12.2018 “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 190 datë 30.8.2018 në lidhje me tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit dhe çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2019” është 1.5 lekë/kWh.

- Nga verifikimi i informacionit dhe përllogaritjeve të paraqitura nga OSHEE sh.a., rezulton se çmimi për shitjen e energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga FMF-ja, për muajin shkurt 2019 është 13.92 lekë/kWh.

- Është konstatuar se OSHEE sh.a. ka faturuar klientët e lidhur në 35 kV për konsumin bazë në pik, si dhe për energjinë reaktive, pavarësisht se ERE nuk është shprehur me vendim për këtë çështje.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimin e furnizimit me energji elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 13.92 lekë/kWh për muajin shkurt 2019.

2. OSHEE sh.a. të kryejë korrigjimet e faturave për muajt në të cilët konstatohet zbatimi i pasaktë i “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017.



3. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi

VENDIM
Nr. 43, datë 15.3.2019

**MBI MIRATIM E “PROPOZIMIT TË TË
GJITHA OST-ve PËR NJË METODOLOGJI
TË OFRIMIT TË DHËNAVE TË
GJENERIMIT DHE NGARKESËS NË
PËRPUTHJE ME NENIN 16 TË
RREGULLORES SË KOMISIONIT (BE)
2015/1222 TË DATËS 24 KORRIK 2015 PËR
KRIJIMIN E NJË UDHËZUESI MBI
ALOKIMIN E KAPACITETEVE DHE
MENAXHIMIN E KONGJESTIONEVE”**

Në mbështetje të neneve 16, 7, 56 dhe 63 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 16 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222, të datës 24 korrik 2015, nenit 26 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, si dhe duke mbajtur në konsideratë se Operatori i Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a., është anëtare me të drejta të plota e ENTSO-E, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 15.3.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Propozimi i të gjitha OST-ve për një metodologji të ofrimit të të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës në përputhje me nenin 16 të rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222, të datës 24 korrik 2015 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve”.

konstatoi se:

- OST sh.a. me shkresën nr. 8383 prot., datë 11.12.2018, ka përcjellë në ERE për miratim “Propozimin e të gjitha OST-ve për një metodologji të ofrimit të të dhënave të gjenerimit

dhe ngarkesës në përputhje me nenin 16 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222, të datës 24 korrik 2015, për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve”.

- Me vendimin nr. 2, datë 17.1.2019, Bordi i ERE-s është shprehur për fillimin e procedurës për miratim të “propozimit të të gjitha OST-ve për një metodologji të ofrimit të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës në përputhje me nenin 16 të rregullores së komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 korrik 2015 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje dhe në zbatim të nenit 26, pikat 3 dhe 5 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, ERE, me shkresën 32/3 prot., datë 14.2.2019, publikoi në median e shkruar njoftimin për fillimin e kësaj procedure; me shkresën nr. 35/9 prot., datë 29.1.2019, ka njoftuar këtë vendim pranë QBZ-së; me shkresat nr. 171 prot. dhe nr. 173 prot; datë 20.2.2019 ka bërë me dije dhe ka kërkuar opinion nga palët e interesit.

- Rezulton se mbas përfundimit të afateve të pritjes së komenteve dhe opinioneve nuk ka komente apo sugjerime në lidhje me këtë akt.

- Dokumenti vjen në vijim të komunikimit nr. 3886 prot., datë 25.5.2018, me objekt “Propozimi i gjithë OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit në përputhje me nenin 18 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719, të datës 26 shtator 2016 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë” dhe është pjesë e të njëjtut kuadër metodologjik të Metodologjisë së Modelit të Përbashkët të Rrjetit.

- Ky propozim vjen në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, me ligjin 8/2018, përkatësisht neni 56 dhe neni 63, si dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Kodin e Transmetimit të miratuar me vendim të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, përkatësisht neni 117 “Kërkesa të përgjithshme për shkëmbimin e të dhënave”, si dhe nenet 118 deri 130 të tij, sipas dokumentit bashkëngjitur është dërguar për miratim “Propozimi i gjithë OST-ve për një metodologji të ofrimit të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës në përputhje me nenin 16 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222, të datës 24 korrik



2015 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve”, të përshtatur në shqip nga OST sh.a., në përputhje me nenin 19 të dokumentit origjinal.

- Dokumenti i përbërë nga 19 nene saktëson kërkesat në lidhje me dorëzimin e të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës të nevojshme për të krijuar modelin e përbashkët nëpërmjet të cilit do të bëhet në nivel evropian analiza e sigurisë me qëllim alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve.

- Në përputhje me vendimin e marrë nga ENTSO-E dhe sipas udhëzimeve të përcjella, kjo metodologji do të zbatohet për të gjithë OST-të e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian të cilat do të përcjellin për miratim tek autoritetet respektive rregullatore. OST-të nga një shtet jo-anëtar i Bashkimit Evropian inkurajohen gjithashtu që ta përcjellin dokumentin pranë Autoritetit Rregullator duke siguruar një përkthim të dokumentit së bashku me versionin në gjuhën angleze.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e “Propozimit të të gjitha OST-ve për një metodologji të ofrimit të të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës në përputhje me nenin 16 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 korrik 2015 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve”.

2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët të versionit shqip.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë palët e interesuara lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi**

VENDIM

Nr. 44, datë 15.3.2019

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “AYEN ENERGY TRADING” SHA, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “d”; nenit 5, pika 1, germa “d”; nenit 13 dhe nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 15.3.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut për rinovimin e licencës së shoqërisë “Ayen Enrgy Trading” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 17, datë 18.2.2019, filloi procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE me shkresën nr. 32/4 prot., datë 18.2.2019, bëri njoftimi në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe me shkresën nr. 93/2 prot., datë 20.2.2019, dërgoi pranë subjektit njoftimin e vendimit, dhe bëri me dije mungesën e dokumentacionit të konstatuar në aplikim.

- Rezulton se mbas përfundimit të afateve të pritjes së komenteve dhe opinioneve nuk ka komente apo sugjerime në lidhje me këtë aplikim.

- Shoqëria “Ayen Energy Trading” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 93/3, datë 4.3.2019, ka plotësuar dokumentacionin e munguar.

- Aplikimi i shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe



afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.7 dhe 4.7.1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi të ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi

VENDIM

Nr. 45, datë 15.3.2019

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “AYEN ENERGY TRADING” SHA, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”; nenit 5, pika 1, germa “e”; nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s

nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.3.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për licencimin e shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i Komisionerëve të ERE-s, me vendimin nr. 18, datë 18.2.2019, filloi procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE me shkresën nr. 32/4 prot., datë 18.2.2019, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe me shkresën nr. 93/2 prot., datë 20.2.2019, dërgoi pranë subjektit njoftimin e vendimit, dhe bëri me dije mungesën e dokumentacionit të konstatuar në aplikim.

- Rezulton se mbas përfundimit të afateve të pritjes se komenteve dhe opinioneve nuk ka komente apo sugjerime në lidhje me këtë aplikim.

- Shoqëria “Ayen Energy Trading” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 93/3, datë 4.3.2019, ka plotësuar dokumentacionin e munguar.

- Aplikimi i shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).



2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi

VENDIM

Nr. 46, datë 19.3.2019

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
OSHEE SHA PËR SHTYRJEN PËR NJË
PERIUDHË TRANZITORE TË AFATIT
TË PAGESËS SË FATURAVE PËR
BLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE
NË TREG TË PARREGULLUAR, NGA
ANA E OSHEE SHA DHE ÇËSHTJE TË
TJERA TË RREGULLIMIT**

Në mbështetje të nenit 10, pika 2, nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 180 i Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 16 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.3.2019 mbasi shqyrtoi kërkesën e OSHEE sh.a., si dhe relacionin e drejtorive teknike, për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë OSHEE sh.a., si dhe shqyrtoi çështjet e parashtruara nga përfaqësuesit e OSHEE sh.a. për shtyrjen për një periudhë tranzitore të afatit të pagesës së faturave për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar, si dhe argumentet e parashtruara nga përfaqësuesi i shoqërisë GEN-i Tiranë sh.p.k.,

konstatoi se:

- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën nr. 5477/1 prot., datë 8.3.2019, nisur nga situata financiare në të cilën ndodhet, i është drejtuar ERE-s me një kërkesë për vendosjen e një periudhe tranzitore, për procedurat e blerjes së energjisë elektrike që do të zhvillohen nga OSHEE sh.a. deri në fund të vitit 2019, në

mënyrë që pagesa e faturës së blerjes së energjisë elektrike të bëhet nga kjo e fundit brenda 180 ditëve nga dita e fundit e lëvrimit dhe jo brenda 90 ditëve siç parashikohet në “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, i ndryshuar.

- Shoqëria OSHEE sh.a. bën me dije si më poshtë:

- Ka vijuar me blerjen e energjisë elektrike gjatë muajve tetor, nëntor, dhjetor 2018, si dhe janar, shkurt, mars 2019, duke siguruar pjesën më të madhe të saj në treg të lirë, për shkak të mungesës së theksuar të prodhimit nga ana e shoqërisë KESH sh.a.

- Jo vetëm që nuk mundi të rikuperojë humbjet e shkaktuara nga thatësira e jashtëzakonshme e vitit 2017, e cila solli rritje të kostos së blerjes së energjisë elektrike, por edhe u përball me një kosto shtesë për blerjen e energjisë elektrike si pasojë e mungesës së furnizimit nga KESH sh.a. në pjesën e dytë të vitit, si dhe nga rritja e prodhimit të Prodhuesve të Pavarur të Energjisë Elektrike në pjesën e parë të vitit 2018. Mungesa e likuiditetit si pasojë e faktorëve sa më sipër e detyroi OSHEE sh.a. të ngadalësojë programin e investimeve në rrjet për vitin 2018, i cili është rreth 2 miliardë lekë më i ulët se ai i parashikuar në programin financiar të miratuar.

- Në të sajën sipër cituar, OSHEE-ja bën me dije se për periudhën janar–shkurt 2019, shpenzimet për blerje të energjisë elektrike ishin 3.714 miliardë lekë ose 29.6 milionë EURO me të larta se ato të planifikuara dhe sipas pritshmërive, kjo gjendje mund të vijojë edhe pjesën e parë të vitit 2019, gjë që ndikon në aftësinë paguese të saj.

- Shoqëria OSHEE sh.a. analizoi me shumë kujdes situatën e jashtëzakonshme dhe sipas këtyre analizave, parashikojë që gjatë muajve shkurt, mars, prill 2019 të përballej me pamundësi financiare të pagesës së faturave të blerjeve në treg të lirë, si pasojë e përplasjes së këtyre pagesave me faturat korrente të HEC-eve dhe KESH sh.a. gjatë muajve janar, shkurt, mars 2019, me afat pagesë 30 ditore, të cilët gjatë këtyre muajve parashikohet të rrisin dukshëm prodhimin e tyre.



- OSHEE sh.a. vlerëson se, risqet dhe dëmet që do të shkaktoheshin nga kjo situatë pamundësi e likuiditetit, të cilat lidhen me penaltitetet që do të aplikoheshin nga shoqëritë tregtare të energjisë, riskun e pamundësisë së blerjes së energjisë elektrike gjatë muajve shkurt, mars etj. 2019, si rezultat i debive të krijuara, do të sillnin përkeqësimin e reputacionit të shoqërisë OSHEE sh.a., si pasojë e mosrespektimit të kontratave ndaj shoqërive tregtare të energjisë.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nëpërmjet shkresës me nr. 64/3, datë 4.3.2019 përcolli në ERE shkresën e OSHEE sh.a. nr. 1785/1 prot., datë 31.1.2019, duke dhënë edhe rekomandimin për vlerësimin e propozimit të shoqërisë OSHEE sh.a., bazuar kryesisht në faktin që OSHEE sh.a. po përballet me një situatë mjaft delikate nga pikëpamja financiare.

- Këtij rekomandimi, i cili vjen në zbatim të nenit 10, pika 2, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, por edhe në cilësinë e aksionarit të shoqërisë OSHEE sh.a., Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ERE iu përgjigj shkresërisht për shkak të kohës së depozitimit të këtij rekomandimi, pas vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën për një ndryshim në “Rregulloren” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016.

- Shoqëria OSHEE sh.a. me shkresën nr. 5477/1 prot., datë 8.3.2019 ka kërkuar dhe bërë me dije se nuk është parashikuar asnjë pagesë për investime, një pjesë e të cilave janë tashmë në vazhdim dhe pezullimi i të cilave do të shkaktonte kosto shtesë.

- E ndodhur në kushtet e rritjes së kostos së blerjes së energjisë, si dhe analizën financiare për përballimin e situatës së krijuar, shoqëria OSHEE sh.a., në vlerësim të risqeve dhe dëmeve potenciale vlerëson të arsyeshme dhe imediate ndryshimin e afatit të pagesës për faturat e blerjes së energjisë elektrike në treg të parregulluar nga ana e saj, duke e vendosur brenda 180 ditëve nga dita e fundit e lëvrimit, për procedurat e blerjes deri në fund të vitit 2019.

- Duke e konsideruar të një rëndësie të veçantë stabilitetin financiar të shoqërisë OSHEE sh.a. edhe për sa i përket interesit publik që ka mbarëvajtja e kësaj shoqërie, si i ngarkuari me detyrimin e shërbimit universal të furnizimit

me energji elektrike mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 244/2016 “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.

- Duke vlerësuar si potencial dëmin financiar (*cash flow*) që mund t'i shkaktohet shoqërisë në kushtet e pamundësisë paguese.

- Duke marrë në konsideratë rekomandimet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për vlerësimin e propozimit të shoqërisë OSHEE sh.a., për ndryshimin në termat e pagesës së parashikuar në “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, në zbatim të nenit 10, pika 2, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

- Duke vlerësuar se periodha tranzitore do të shtrihet për një kohëzgjatje jo më të madhe se periodha në të cilën parashikohet që shoqëria OSHEE sh.a. të ndodhet në kushtet e kryerjes së pagesave në masën më të lartë gjatë vitit kalendarik (mars–qershor), për shkak të detyrimit për blerjen e të gjithë energjisë së prodhuar nga Prodhuesit me Përparësi të Energjisë Elektrike, në zbatim të detyrimeve të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 244/2016 “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.

- Mbështetur në parashikimet e nenit 180 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë: “Ekzekutimi i detyrueshëm pezullohet kryesisht ose me kërkesë të subjektit të ekzekutimit në rastet kur: a) vërtetohet se ekziston rreziku i shkakut të një dëmi të rëndë dhe të pazëvendësueshëm për subjektin e ekzekutimit dhe pezullimi në këtë rast nuk e cenon interesin publik”.

- OSHEE sh.a. bëri me dije se shoqëria KESH sh.a. me anë të shkresës nr. 1088 prot.,



datë 25.2.2019 sqaroi se, pasi rivlerësoi situatën hidrike në vend, planifikon të rishikojë programin e prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 1 mars–31 dhjetor 2019. Nga parashikimet e raportuara nga KESH sh.a. në të sajën sipërcituar, sasia maksimale e prodhimit e garantuar për vitin 2019 me probabilitet sukseesi 70% është në vlerën 2960 mw, ndërsa sasia e garantuar për të njëjtën periudhë, me probabilitet sukseesi 80% është në vlerën 2633 mw.

- Mbështetur në parashikimet e VKM-së nr. 244/2016 “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, parashikohet se në rastet kur FSHU-ja nuk mund të sigurojë sasinë e nevojshme nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike në përputhje me parashikimet e kontratës së rregulluar ndërmjet palëve, FSHU-ja, ka detyrimin që të sigurojë sasinë e nevojshme të energjisë në tregun e parregulluar. FSHU-ja kompensohet nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike për sasinë e pasiguar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike sipas vlerës së përcaktuar në kontratë.

- Duke qenë në dijeni të transaksioneve të energjisë së kryer mes OSHEE sh.a. dhe tregtareve të energjisë elektrike përgjatë periudhës 1 janar 2019 deri në këtë vendimmarrje, nën termat e pagesës së deklaruar nga OSHEE sh.a. dhe të pranuar nga tregtarët pjesëmarrës në ankand e fitues.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pezullimin e zbatimit të nenit 20, germa “a” të “Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike, për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, për sigurimin e energjisë elektrike nga ana e shoqërisë OSHEE sh.a.

2. Vendosjen e një periudhe tranzitore prej 3 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, gjatë së cilës afati i kryerjes së pagesave nga shoqëria OSHEE sh.a. për tregtarët fitues të ankandeve të

shitblerjes së energjisë elektrike me qëllim sigurimin e energjisë elektrike për përmbushjen e nevojave të klientëve fundorë, mund të jetë jo më vonë se 180 ditë nga dita e lëvrimit të energjisë elektrike

3. Pagesa që OSHEE-ja do të kryejë ndaj çdo tregtari me të cilin ka siguruar blerjen e energjisë të jetë proporcionale, deri në ekzekutimin e plotë të detyrimit për secilin tregtar, por jo më vonë se 180 ditë nga dita e lëvrimit të energjisë.

4. OSHEE sh.a. të informojë çdo fundmuaji në ERE në lidhje me ecurinë e zbatimit të këtij vendimi.

5. OSHEE sh.a. të rishikojë programin e zhvillimit ekonomik në funksion të ndryshimeve të këtyre efekteve financiare të parashtruara në shkresën e shoqërisë nr. 5477/1 prot., datë 8.3.2019.

6. OSHEE sh.a. dhe furnizuesit të cilët kanë dakordësuar dhe kryer shitblerjen e energjisë elektrike nën termat e ftesës së shpallur të OSHEE, që nga data 1 janar deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi të respektojnë reciprokisht termat e ftesës së shpallur të OSHEE sh.a. dhe të ofertave të pranuar të tregtarëve të energjisë elektrike.

7. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi



VENDIM
Nr. 47, datë 19.3.2019

**MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË
OST SHA PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN E ERE-s NR. 43 DATË
15.3.2017 MBI MIRATIMIN
PËRFUNDIMTAR TË CERTIFIKIMIT
TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE OST SHA NË PËRPUTHJE
ME NENIN 54, PIKA 6, TË LIGJIT NR.
43/2015, “PËR SEKTORIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE” DHE NENIN 9, PIKA 6, TË
DIREKTIVËS 72/2009 EC MBAS
MARRJES SË OPINIONIT TË
SEKRETARIATIT TË KOMUNITETIT
TË ENERGJISË**

Në mbështetje të nenit 3, pika 8 dhe neneve 16; 54 dhe 58, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 53, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”; neneve 3; 6; 8 dhe 10 të “Rregullave për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 154, datë 11.12.2015, të Bordit të ERE-s, nenit 8 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.3.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, mbi kërkesën e OST sh.a., për shtyrjen e afatit të pikës 2 të vendimit të ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të direktivës 72/2009 EC mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 59, datë 15.3.2018 vendosi: të miratojë kërkesën e OST sh.a. për shtyrjen e afatit të zbatimit të pikës 2, të vendimit të ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me

nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të direktivës 72/2009 EC mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, deri në datën 15.3.2019.

- Kjo shtyrje u miratua për shkak të pamundësisë së OST sh.a. për të përmbushur të gjitha kushtet brenda afatit të përcaktuar në vendimin e bordit të ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017.

- OST sh.a. me shkresën nr. 1134/1 prot., datë 13.3.2019, i është drejtuar ERE në përgjigje të kërkesës për informacion nr. 136 prot., datë 6.2.2019, në lidhje me plotësimin e kushteve të vendosura nga ERE në vendimin e certifikimit, duke shpjeguar për secilin si më poshtë:

- **Pavarësinë e audituesit financiar**, për të cilën shpjegon se auditues të pavarur të caktuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e pronarit të OST sh.a., kanë kryer auditimin e pasqyrave financiare të OST sh.a. për vitin 2017 dhe po vijojnë punën me ato të vitit 2018. MFE ka emëruar ekspertë që nuk ushtrojnë auditim në kompanitë shtetërore të prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike.

- **Mostransferimin e stafit**, OST sh.a. bën me dije ERE-n se ka kryer ndryshime në kontratën kolektive të punës, ku ka përcaktuar se punonjësit që mbajnë pozicione “Drejtori” dhe raportojnë drejtpërdrejt tek administratori i shoqërisë dhe “Shef sektori” të lidhur me veprimtarinë e përditshme të OST sh.a., nuk do të punësohen pranë ndërmarrjeve që kryejnë veprimtaritë e prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike. OST sh.a. ka bërë me dije edhe më herët ERE-n për përmbushjen e këtij detyrimi me shkresën nr. 2143 prot., datë 16.3.2018.

- **Ndarja e Operatorit të Tregut**. Për realizimin e këtij qëllimi, OST sh.a. duhet të marrë masat paraprake dhe të bashkëpunojë brenda kompetencave të saj për realizimin e detyrimeve ligjore të përcaktuara në ligj, për sigurimin e përmbushjes së detyrimit për ndarjen financiare dhe ligjore të Operatorit të Tregut, siç është parashikuar në nenin 57/2 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, në përputhje me rregullat e tregut të miratuara nga ERE dhe në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave për ndarjen e Operatorit të Tregut.



- **Programin e pajtueshmërisë dhe zyrtari i pajtueshmërisë**, OST sh.a. bën me dije ERE-n se në lidhje me këtë detyrim janë marrë vendimet e ERE-s nr. 147, datë 28.9.2017 për miratimin e kontratës për Zyrtarin e Pajtueshmërisë dhe me vendimi nr. 103, datë 30.4.2018 për miratimin e Programit të Pajtueshmërisë.

- Ndërsa sa i përket kushtit të paplotësuar ende në lidhje me Bashkëpunimin ndër-institucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor dhe transferimi i kompetencave të Ministria e Ekonomisë, OST sh.a. bën me dije ERE-n se, në lidhje me këtë detyrim ka mbajtur korrespondencë të vazhdueshme me të gjithë institucionet përkatëse me qëllim përmbushjen e tij me sukses. OST sh.a. i është drejtuar MIE me propozimin për ndryshime në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar që do të çonin në përmbushjen e kushtit të vendosur.

- OST sh.a. në korrespondencë, e thekson se ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për përmbushjen e plotë të të gjitha kushteve të certifikimit, por në rastin e Bashkëpunimit ndër-institucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor dhe transferimi i kompetencave të Ministria e Ekonomisë, OST sh.a. nuk ka mundësi të veprojë në mënyrë të drejtpërdrejtë për përmbylljen e këtyre iniciativave. OST sh.a. beson në bashkëpunimin me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për realizimin në një kohë sa më të shpejtë dhe me sukses të këtyre iniciativave, për të cilat do të duhet një kohë më e gjatë se ajo e vënë në dispozicion me vendimin nr. 59, datë 15.3.2018, i cili ka shtyrë me një vit afatin e parashikuar në pikën 2 të vendimit nr. 43, datë 15.3.2017, të Bordit të ERE-s.

- Në vijim të raportimit sa më sipër, për shkak të rrethanave të cilat nuk varen nga vullneti i OST sh.a. për të zbatuar parashikimet e vendimit të ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të Certifikimit të Operatorit të Sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të direktivës 72/2009 EC mbas marrjes së Opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”, OST sh.a. i është drejtuar ERE-s me kërkesën për shtyrjen me 1 vit të afatit të përmbushjes të

kushteve të parashikuara në pikën 2 të vendimit të ERE-s sa më sipër.

- Kërkesa e OST sh.a. është depozituar në ERE, me shkresën nr. 1134/1 prot., datë 13.3.2019, dhe duke marrë në konsideratë që afati i vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 59, datë 15.3.2018 (vendim i cili ka ndryshuar afatin e vendosur në pikën 2, të vendimit nr. 43, datë 15.3.2017), plotësohet në datën 15.3.2019, shqyrtimi i kësaj kërkesë përpara përfundimit të afatit, plotëson kushtet sa më sipër në zbatim edhe të nenit 53 të Kodit të Procedurave Administrative i cili citon: “afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit”.

- Nga analiza e rrethanave të shpjeguara nga OST sh.a., konstatohet si të drejtë konkluzionin e OST sh.a. që prej saj janë bërë të gjitha përpjekjet për përmbushjen e kushteve të përcaktuara në vendimin e ERE nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të direktivës 72/2009 EC mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë” dhe se procesi i ndryshimeve në ligj kërkon një kohë të gjatë për shkak të procedurave që duhet të ndiqen deri në shqyrtimin dhe miratimin në Kuvend të ndryshimeve të propozuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e OST sh.a. për shtyrjen e afatit të zbatimit të pikës 2, të vendimit të ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të direktivës 72/2009 EC mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”.

2. Ky vendim hyn në fuqi që nga data 15.3.2019 dhe shteron fuqinë juridike në 15.12.2019.



3. Të përcjellë këtë vendim OST sh.a., Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë; Autoritetit të Konkurrencës dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT**

Erjola Sadushi

VENDIM

Nr. 90, datë 27.3.2019

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË DEMOKRATIKE, QARKU ELBASAN, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 27.3.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri kryetar;
Denar Biba zv.kryetar;
Bledar Skënderi anëtar;
Edlira Jorgaqi anëtare;
Rezarta Bitri anëtare.

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Elbasan, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, z. Edmond Shyqyri Spaho.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, neni 175, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 792/1 prot., datë 25.2.2019, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancave në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandateve të deputetëve të zonës zgjedhore të subjektit politik Partia Demokratike, qarku Elbasan.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën shumemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Demokratike për zonën zgjedhore qarku Elbasan, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017, ka fituar 3 (tri) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, qarku Elbasan, janë numri rendor 1 (një) z. Edmond Shyqyri Spaho, me numër rendor 2 (dy) z. Endri Nuri Hasa, me numër rendor 3 (tre) z. Luciano Dhimitër Boçi.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Demokratike, qarku Elbasan, nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë, duke mos pasur tridhjetë për qind të listës shumemërore nga secila gjini. KQZ-ja, me vendimin nr. 566, datë 5.10.2017, vendosi sanksionin administrativ gjobë në masën 12.000.000 (dymbëdhjetë) milionë lekë ndaj Partisë Demokratike.

Në bazë të nenit 175, pika 2 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, në zonën zgjedhore qarku Elbasan, duhet të zbatonte dhe sanksionin



plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ-ja, pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancave, për shkak të heqjes dorë nga mandatet e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, të subjektit politik Partia Demokratike, qarku Elbasan, i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 7 (shtatë), 17 (shtatëmbëdhjetë) dhe 4 (katër), dorëzimin e formularit të vetdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimet 47, 48, 49, datë 12.3.2019 ka vendosur, të shpall moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mos dorëzimit të formularit të vetdeklarimit brenda afatit ligjor.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, kandidatët vijues nga gjinia më pak e përfaqësuar e listës shumemërore e Partisë Demokratike, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, qarku Elbasan, kanë shteruar. Në bazë të nenit 164, pika 2 e Kodit Zgjedhor, fjalë e fundit, kandidati vijues të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati për deputet me numër rendor 5 (pesë), z. Arben Mentor Elezi.

Referuar nenit 11 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Me shkresën nr. 1436 prot., datë 13.3.2019, z. Arben Mentor Elezi, është njoftuar për dorëzimin e formularit të vetdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Z. Arben Mentor Elezi, referuar ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka depozituar në Komisionin

Qendror të Zgjedhjeve, më datë 21.3.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2122, duke pranuar propozimin e organit për vazhdimin e procedurave për marrjen e mandatit.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të z. Arben Mentor Elezi, rezulton se: nuk ka deklaruar dënime penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreut V, pika 2, germa “b” dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1638 prot., datë 25.3.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 1639 prot., datë 25.3.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Elbasan, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Arben Mentor Elezi.

KQZ-ja, gjithashtu, ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Në përgjigje të shkresës nr. V-834/1 prot., datë 25.3.2019, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Elbasan, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Arben Mentor Elezi, sipas së cilës rezulton se është i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Arben Mentor Elezi, rezulton se, nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidadit të radhës të listës shumemërore e Partisë Demokratike në zonën zgjedhore qarku Elbasan, i renditur me numër rendor 5 (pesë), z. Arben Mentor Elezi.



PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, neni 175, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Elbasan, z. Arben Mentor Elezi.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (ditë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETARI

Klement Zguri

VENDIM

Nr. 91, datë 27.3.2019

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË
DEPUTETIT TË KUVENDIT TË
SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS
SHUMEMËRORE TË PARTISË LËVIZJA
SOCIALISTE PËR INTEGRIM, QARKU
SHKODËR, PËR PLOTËSIMIN E
VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA
KUVENDI I SHQIPËRISË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 27.3.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri kryetar;
Denar Biba zv.kryetar;
Bledar Skënderi anëtar;
Edlira Jorgaqi anëtare;
Rezarta Bitri anëtare.

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatis të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Shkodër, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, z. Agron Elez Çela.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Faqe | 3678

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 792/1 prot., datë 25.2.2019, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandatis të deputetit të zonës zgjedhore, qarku Shkodër, të subjektit politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatis të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatis, kandidatit të radhës në listën shumemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, për zonën zgjedhore qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017, ka fituar 1 (një) mandat dhe kandidati fitues nga lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Shkodër, është numri rendor 1 (një) z. Agron Elez Çela.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Shkodër, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor me kandidatin vijues të listës së partisë Lëvizja Socialiste për Integrim.



Gjithashtu, konstatojmë se vakanca nuk i përket një mandati të fituar sipas pikës 6, të nenit 67, të Kodit Zgjedhor, për të zbatuar përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, fjalia e dytë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë duhet t'i kalojë kandidatit vijues të listës së Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në zonën zgjedhore qarku Shkodër.

KQZ-ja, pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancës, për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të z. Agron Elez Çela, qarku Shkodër, i ka kërkuar kandidatit vijues të listës shumemërore me numër rendor 2 (dy), z. Dritan Rifat Hylli dorëzimin e formularit të vetdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin 53, datë 12.3.2019 ka vendosur, të shpall moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Shkodër, z. Dritan Rifat Hylli, si rezultat i mos dorëzimit të formularit të vetdeklarimit brenda afatit ligjor.

Në bazë të nenit 164, të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, qarku Shkodër, të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati për deputet me numër rendor 3 (tre) znj. Amra Luan Barova.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Znj. Amra Luan Barova, referuar ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 21.3.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2123.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të znj. Amra Luan Barova, rezulton se, nuk ka deklaruar dënime penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreut V, pika 2, germa “b” dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1638 prot., datë 25.3.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 1639 prot., datë 25.3.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Shkodër, për Kuvendin e Shqipërisë, znj. Amra Luan Barova, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Në përgjigje të shkresës nr. V-834/1 prot., datë 25.3.2019, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Shkodër, për Kuvendin e Shqipërisë, znj. Amra Luan Barova, sipas së cilës rezulton se është i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të znj. Amra Luan Barova, rezulton se, nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidatit të radhës të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në zonën zgjedhore qarku Shkodër, i renditur me numër rendor 3 (tre), znj. Amra Luan Barova.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,



VENDOSI:

1. T'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integritet, qarku Shkodër, znj. Amra Luan Barova.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETARI
Klement Zguri

VENDIM

Nr. 92, datë 27.3.2019

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË
DEPUTETIT TË KUVENDIT TË
SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS
SHUMEMËRORE TË PARTISË
DEMOKRATIKE, QARKU VLORE, PËR
PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË
NJOFTUAR NGA KUVENDI I
SHQIPËRISË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 27.3.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri kryetar;
Denar Biba zv.kryetar;
Bledar Skënderi anëtar;
Edlira Jorgaqi anëtare;
Rezarta Bitri anëtare.

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatis të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Vlorë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, z. Agron Siri Shehaj.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", neni 164, neni 175, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 792/1 prot., datë 25.2.2019, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancave në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandateve të deputetëve të zonës zgjedhore të subjektit politik Partia Demokratike, qarku Vlorë.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatis të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatis, kandidatit të radhës në listën shumemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Demokratike për zonën zgjedhore Qarku Vlorë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017, ka fituar 3 (tri) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, Qarku Vlorë, janë numri rendor 1 (një) z. Agron Siri Shehaj, me numër rendor 2 (dy) znj. Nadire Fevri Mecorapaj, me numër rendor 3 (tre) z. Vangjel Jorgji Dule.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Demokratike, Qarku Vlorë, nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë, duke mos pasur tridhjetë për qind të listës shumemërore nga secila gjini. KQZ-ja, me vendimin nr. 566, datë 5.10.2017 vendosi sanksionin administrativ gjobë në masën 12.000.000 (dymbëdhjetë) milion lekë ndaj Partisë Demokratike.

Në bazë të nenit 175, pika 2 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, në zonën zgjedhore qarku Vlorë duhet të zbatonte dhe sanksionin



plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ-ja, pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancave, për shkak të heqjes dorë nga mandatet e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, të subjektit politik Partia Demokratike, qarku Vlorë, i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 8 (tetë), 4 (katër) dhe 5 (pesë), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimet 59, 60, datë 12.3.2019 dhe 73 datë 20.3.2019, ka vendosur, të shpall moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mos dorëzimit të formularit të vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, kandidatët vijues nga gjinia më pak e përfaqësuar e listës shumemërore e Partisë Demokratike, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, qarku Vlorë, kanë shteruar. Në bazë të nenit 164, pika 2 e Kodit Zgjedhor, fjalë e fundit, kandidati vijues të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati për deputet me numër rendor 6 (gjashtë), z. Adriatik Bektash Alimadhi.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Me shkresën nr. 1437 prot., datë 13.3.2019, z. Adriatik Bektash Alimadhi është njoftuar për dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Z. Adriatik Bektash Alimadhi, referuar ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka depozituar në Komisionin

Qendror të Zgjedhjeve, më datë 21.3.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2124, duke pranuar propozimin e organit për vazhdimin e procedurave për marrjen e mandatit.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të z. Adriatik Bektash Alimadhi, rezulton se: nuk ka deklaruar dënime penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreut V, pika 2, germa “b” dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1648 prot., datë 25.3.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 1647 prot., datë 25.3.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Vlorë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Adriatik Bektash Alimadhi.

KQZ-ja, gjithashtu, ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Në përgjigje të shkresës nr. V-857/1 prot., datë 25.3.2019 zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Vlorë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Adriatik Bektash Alimadhi, sipas së cilës rezulton se është i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Adriatik Bektash Alimadhi, rezulton se, nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidadit të radhës të listës shumemërore e Partisë Demokratike në zonën zgjedhore qarku Vlorë, i renditur me numër rendor 6 (gjashtë), z. Adriatik Bektash Alimadhi.



PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, nenin 175, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Demokratike, qarku Vlorë, z. Adriatik Bektash Alimadhi.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (ditë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETARI

Klement Zguri

VENDIM

Nr. 88, datë 15.3.2019

**AUTORIZIM I NDIHMËS
SHTETËRORE “PËR FUQIZIMIN E
GRAVE DHE NXITJA E
SIPËRMARRJES”**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

- | | |
|-----------------------|-----------|
| - Znj. Anila Denaj | kryetare; |
| - Znj. Mimoza Dhëmbi | anëtare; |
| - Znj. Etleva Haka | anëtare; |
| - Znj. Mirjana Zisi | anëtare. |
| - Z. Ahmet Mançellari | anëtar. |

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 15.3.2019, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005 “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, morri në shqyrtim njoftimin e Bashkisë Tiranë lidhur me planin e dhënies së ndihmës shtetërore për fuqizimin e grave dhe nxitjen e sipërmarrjes.

I. Procedura

1. Bashkia Tiranë, me shkresën nr. 4279, datë 25.1.2019, në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të

ndryshuar njoftoi në Komisionin e Ndihmës Shtetërore planin e ndihmës shtetërore të sipërmendur, në bazë të vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 159, datë 21.12.2018 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2019–2021 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2019”.

II. Përshkrimi i masës

2. *Objekti:* Plani i ndihmës ka si objekt mbështetjen e sipërmarrësve femra, me ide të qarta për aktivitetin e tyre, për fillimin ose zgjerimin e biznesit, me vendndodhje në territorin e Bashkisë së Tiranës.

3. *Baza ligjore e njoftimit të planit:* Plani i ndihmës shtetërore është miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës nr. 159, datë 21.12.2018 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2019–2021 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2019”, në programin “Kujdesi social dhe solidariteti”, në vlerën gjithsej 10.000.000 lekë.

4. *Kobëzgjatja:* Plani i ndihmës do të zbatohet në vitin 2019.

5. *Dhënësi i ndihmës* dhe autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës është Bashkia e Tiranës.

6. *Përfituesit:* Përfitues janë gratë sipërmarrëse që synojnë fillimin ose zgjerimin e biznesit të pavarur të vogël ose shumë të vogël, që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e Bashkisë së Tiranës.

7. *Shtrirja territoriale:* Projekti do të zbatohet në territorin e Bashkisë së Tiranës.

8. *Forma dhe vlera e ndihmës:* Vlera e ndihmës shtetërore për vitin 2019 është 10.000.000 (dhjetë milionë) lekë në formën e grantit të drejtpërdrejtë nga fondet e miratuara për Bashkinë e Tiranës. Çdo përfitues do të mbështetet në shumën 500,000 lekë (pesëqind mijë lekë).

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

9. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson nëse plani i ndihmës shtetërore për fuqizimin e grave dhe nxitjen e sipërmarrjes, përbën ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, pra nëse plani ofron një avantazh ekonomik për ndërmarrje, të cilat kanë një ndikim të mundshëm në konkurrencë dhe tregtinë midis shteteve anëtare, që nuk do të ishte përfutur në kushte normale të tregut.



10. Neni 4, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, përcakton se:

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme e cila, në mënyrë të drejtpërdrejt ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”.

11. Gjithashtu, neni 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë¹ përcakton se:

“Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”.

12. Ligji i ndihmës shtetërore zbatohet vetëm për masat që plotësojnë të gjitha kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1, konkretisht: a) burime shtetërore; b) avantazhi ekonomik; c) selektiviteti; dhe d) efekti në konkurrencë dhe treg.

13. Bashkia e Tiranës, ka njoftuar planin e ndihmës shtetërore, i cili lidhet me aktivizimin e burimeve shtetërore në formën e grantit, me qëllim mbështetjen e disa (20) ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në territorin e bashkisë. Plani i ndihmës së njoftuar ka potencial për të ndikuar në konkurrencë dhe në tregti, duke qenë se përmirëson situatën ekonomike të disa ndërmarrjeve në treg.

Në këto kushte Komisioni vlerëson se plani i njoftuar është ndihmë shtetërore.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

14. Komisioni i Ndhmës Shtetërore vlerëson skemën e njoftuar në bazë të VKM-së nr. 513, datë 4.9.2018 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore”, neni 12 “Ndihmë për ndërmarrje të vogla të sapokrijuara nga sipërmarrëset femra”, sipas së cilës skemat e ndihmës shtetërore në favor të ndërmarrjeve të vogla të krijuara nga sipërmarrëse femra lejohen nëse plotësohen kushtet e këtij neni *si edhe* kushtet e kreut III, si më poshtë:

- transparenca e ndihmës;
- efekti nxitës i ndihmës shtetërore;
- për qëllim të llogaritjes së intensitetit të ndihmës dhe kostove të pranueshme, të gjitha vlerat e përdorura, janë ato të llogaritura para zbritjes së taksave apo detyrimeve të tjera;
- shuma totale e ndihmës shtetërore e dhënë në favor të aktivitetit, projektit ose ndërmarrjes nuk i kalon 7,5 milionë euro për ndërmarrje; dhe
- dhënësi i ndihmës shtetërore merr masa të publikojë në faqen zyrtare të internetit të dhënat e skemës.

15. Bashkia e Tiranës nëpërmjet planit të njoftuar të ndihmës, plotëson kushtet e sipërcituara, duke qenë se:

- skema e ndihmës do të jepet në formën e granteve;
- ndihma konsiderohet të ketë efekt nxitës duke qenë se përfituesi do të dorëzojë një aplikim me shkrim për ndihmën shtetërore pranë dhënësit të ndihmës shtetërore, para kryerjes së shpenzimeve për kryerjen e aktivitetit;
- kostot e pranueshme do të shoqërohen me dokumente justifikuese, të cilat janë të qarta, specifike dhe të përditësuara;
- shuma totale e ndihmës shtetërore e dhënë në favor të aktivitetit, projektit ose ndërmarrjes nuk i kalon 7,5 milionë euro për ndërmarrje, çdo ndërmarrje do të përftojë 500 000 lekë;

Sa më lart, Komisioni vlerëson se plani i ndihmës shtetërore është i lejueshëm në përputhje me nenin 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore” të ndryshuar, si dhe kushteve të kreut II dhe të nenit 12 të VKM-së nr. 513, datë 4.9.2018 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore”.

¹ Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së stabilizim-asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare”.



PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 17, 22, dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, dhe nenin 12, të VKM-së nr. 513, datë 4.9.2018 “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore’”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë skemën e ndihmës shtetërore në formën e grantit për “Fuqizimin e grave dhe nxitjen e sipërmarrjes”, të miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 159, datë 21.12.2018 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2019–2021 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2019.

2. Bashkia e Tiranës të sigurojë se:

- intensiteti i ndihmës shtetërore *nuk* do të kalojë 15% të kostove të pranueshme të shkaktuara gjatë 5 viteve të para të krijimit të ndërmarrjes;

- ndërmarrjet e vogla të kontrolluara nga aksionarët e ndërmarrjeve që janë mbyllur në 12

muajt e fundit nuk mund të përfitojnë nga ndihma;

- do të publikojë në faqen zyrtare të internetit Informacionin përmbledhës të referuar në formatin e standardizuar të përcaktuar në shtojcën I ose *link*-un e informacionit sipas parashikimeve të nenit 9 të VKM nr. 513, datë 4.9.2018.

3. Bashkia e Tiranës, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e bëra dhe produktet e arritura.

4. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

5. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Anila Denaj

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 336 lekë